



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.07.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me Institucionin e Avokaturës së Shtetit për raportimin vjetor të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për vitin 2018. *(Komision përgjegjës)*

2. Seancë dëgjimore me zëvendëskryeministrin për politikat në shërbimin civil dhe zbatimin e tyre (raporti i Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2018) *(Komision përgjegjës)*

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Edmond Leka, Alban Zeneli, Andi Përmeti dhe Elda Hoti

**Mungojnë:**

Damian Gjikhuri dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Artur Metani - Avokat i Përgjithshëm i Shtetit

Eva Dyrmishi - Avokate e Shtetit

Erion Braçe – Zëvendëskryeministër

Albana Koçiu – Drejtoreshë e Departamentit të Administratës Publike

Agathi Kuramano – Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave të Rekrutimit në DAP

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje, të cilat lidhen me ushtrimin e funksionit të kontrollit parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë. Komisioni i Ligjeve ka funksionin e ushtrimit të kontrollit parlamentar për institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së tij.

Sot kemi në seancë dëgjimore institucionin e Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit raporton para Komisionit të Ligjeve për herë të parë sot falë ndryshimeve që ne i bëmë ligjit “Për Avokaturën e Shtetit” në vitin 2018. Respektivisht, Avokati i Shtetit është sot në zbatim të nenit 19/9 të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”, ku në parashikimet e reja ligjore Avokati i Përgjithshëm i Shtetit paraqet raport, të paktën 1 herë në vit para Komisionit të përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim. Pra, fokusi i raportimit të Avokatit të Shtetit është për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ai raporton vetëm para Komisionit të Ligjeve dhe jo në seancë plenare të Kuvendit. Efektivisht, Komisioni i Ligjeve, në përfundim të kësaj seance dëgjimore, do të përpilojë një raport, i cili do t’i vihet në dispozicion Kryetarit të Kuvendit dhe do të botohet në Fletoren Zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe kolegja Klotilda Bushka është relatore. Sot kemi prezent zotin Artur Metani, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit dhe zonjën Eva Dyrmishi, Avokate e Shtetit.

Zoti Avokat, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

**Artur Metani** – Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Materiali i përmbledhur i sjellë nga Avokati i Shtetit u është shpërndarë kolegëve deputetë. Fokusi i raportimit është për një periudhë kohore të shkurtër nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit deri në periudhën e raportimit, pra, përfshi periudhën janar 2018-qershor 2019. Ju lutem, bëni një përmbledhje të këtij raporti për kolegët e mi deputetë dhe më pas të kalojmë në pyetje dhe përgjigje.

Fjala për ju!

**Artur Metani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar deputetë,

Avokatura e Shtetit e ushtron aktivitetin e saj në bazë të ligjit nr. 10018 të vitit 2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, si dhe të akteve nënligjore, VKM 392 e vitit 2009 dhe VKM 381 e vitit 2019 të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, e miratuar me urdhrin 688 “Avokati i Përgjithshëm i Shtetit” në mars të vitit 2018.

Avokatura e Shtetit në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 19 të ligjit nr. 10018 “Për Avokaturë e Shtetit” paraqet raport të paktën një herë në vit para Komisionit të përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim. Ky raport reflekton punën e Avokatit të Shtetit gjatë periudhës janar 2018-qershor 2019, duke dhënë informacion për objektivat e arritura dhe për masat e marra për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut gjatë kësaj periudhe.

Ligji nr. 86/2018 solli risi të rëndësishme për funksionimin dhe organizimin e institucionit të Avokaturës së Shtetit, veçanërisht në drejtim të procedurës së ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në legjislacionin tonë, deri në miratimin e ndryshimeve ligjore në muajin dhjetor të vitit të kaluar, një rregullim i tillë nuk ishte formalizuar. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut bëhej sipas një praktike të ndjekur në vite, por pa pasur parashikime të qarta ligjore. Për herë të parë në ligjin nr. 86/2018 të legjislacionit shqiptar u përcaktua një procedurë e qartë e ekzekutimit të vendimit të gjykatës, u ngrit një organ këshillimor, i cili luan një rol të rëndësishëm në gjetjen e zgjidhjeve efektive për ekzekutimin e masave të përgjithshme apo individuale të përcaktuara në vendimet e Gjykatës së Strasburgut, si dhe u vendosën afate e procedura të qarta për ekzekutimin e tyre.

Vendimmarrja e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për periudhën janar – dhjetor të vitit 2018.

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2018 Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka dalë me 10 vendime për Shqipërinë, ku ka vendosur mospranimin për dy ankesa dhe pranimin e 8 ankesave të tjera. Ankesat e pranuar kanë të bëjnë me respektimin e nenit 6 të Konventës, i cili është procesi i rregullt ligjor.

Gjykata ka konstatuar se në 5 vendime ka shkelje të nenit 6/1 të Konventës për shkak të zhvillimit të procedurës penale në mungesë. Në dy vendime është konstatuar shkelja e nenit 3, nga ana procedurale, pra realizimi i një hetimi efektiv dhe në një vendim, krahas nenit 6/1, në aspektin civil është shkelur edhe neni 1 i protokollit nr.1

Të gjitha vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut janë botuar në Fletoren Zyrtare, në respektim të neneve 44 dhe 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2019 janë iniciuar edhe një herë procedurat për ekzekutimin e 4 vendimeve të GjEDNj-së, të marra përpara janarit të vitit 2019. Dy vendime janë marrë në vitin 2018, Pihoni dhe Topi, ndërsa dy vendimet e tjera janë marrë më parë, në vitin 2016 rasti Gjermani dhe në vitin 2017 rasti Cakaj.

Dua të them se tre nga këto vendime janë ekzekutuar me procedurë të parashikuar për herë të parë në legjislacion. Ekzekutimi i tyre është bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me kërkesë të Avokaturës së Shtetit bazuar në nenin 19/5 të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”, duke qenë se shuma ishte më e vogël se 10 mijë euro. Vlera financiare e katër vendimeve është rreth 10400 euro.

Në vendimet e gjykatës, të dhëna gjatë vitit 2018, vetëm njëra prej tyre është në fazë ekzekutimi për shkak të shumës së madhe që parashikon. Avokatura e Shtetit së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka iniciuar edhe një herë procedurat për ekzekutimin e tij.

Vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut monitorohen nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, i cili është organi kompetent i përcaktuar nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, për të kryer këtë funksion.

Gjatë vitit 2018 Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka ndjekur me procedurë të përshpejtuar dy vendime: “Luli e të tjerë kundër Shqipërisë” dhe “Manushaqe Puto kundër Shqipërisë”.

Vendimi i “Lulit dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, datë 15.09.2015. Në këtë vendimin gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6/1, që është tejzgjatja e procedurave gjyqësore dhe të nenit 13, që është mungesa e një mjeti efektiv, për sa i përket zbatimit të nenit 6/1 të Konventës. Gjykata në këtë vendim, në vijim të gjetjeve të saj në vendime të mëparshme kundër Shqipërisë, konstatoi tejzgjatjen e paarsyeshme të procesit ligjor si një praktikë e konsoliduar, duke e gjetur si një mangësi serioze në sistemin ligjor shqiptar.

Në datën 15 tetor të vitit 2018 qeveria shqiptare ka paraqitur pranë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës planin e veprimit të përditësuar për vendimin “Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në të cilën ka bërë një panoramë të masave të marra nga qeveria për ekzekutimin e masave të përgjithshme të këtij vendimi dhe gjetjen e një zgjidhje efektive për konstatimet e gjykatës në këtë grup çështjesh.

Qeveria ka vlerësuar se ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për “Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, duke zgjedhur t’i realizojë nëpërmjet ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile, ligjin nr. 38/2017, parashikimin e mjeteve efektive, të cilat mundësojnë kompensimin për dëmin e shkaktuar nga kohëzgjatja e paarsyeshme, si dhe përshpejtimin e procedurave në rastet kur çështja është në gjykim.

Në mbledhjen e dhjetorit të vitit 2018 Komiteti i Ministrave të Këshillave të Europës, pasi shqyrtoi masat e marra nga qeveria shqiptare, i vlerësoi pozitivisht duke u shprehur: “Për sa u përket masave të përgjithshme, mirëpritën përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve për të zvogëluar vonesat në procedurat gjyqësore dhe ngarkesën e punës së gjykatave përmes miratimit të një game të gjerë masash legislative dhe praktike”. Ata mirëpritën prezantimin e mjetit të ri përshpejtues dhe kompensues për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe vunë në dukje rastet e para të raportuara, në të cilat është përdorur ky mjet efektiv.

Komiteti ftoi autoritetet që të miratojnë sa më shpejt masat për të adresuar problemet në tejzgjatjen e procedurave në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e apelit civil, në veçanti për të siguruar zëvendësimin e gjyqtarëve që janë shkarkuar apo kanë dhënë dorëheqjen si rezultat i procesit të vetingut, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, ftoi autoritetet të dorëzojnë informacionet shtesë për çështjet e mësipërme deri në 30 qershor të vitit 2019.

Avokatura e Shtetit ka informuar departamentin e ekzekutimeve të vendimit të GjEDNj-së se do të raportojë, për sa kërkohet nga Komiteti i Ministrave, brenda korrikut të vitit 2019.

Vendimi i “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

Gjykata në këtë vendim ka gjetur shkelje për sa i përket nenit 6/1 të Konventës, për tejzgjatje të procedurave administrative dhe gjyqësore, mosekzekutime të vendimeve të formës së prerë të nenit 13, për mungesën e një mjeti efektiv për ekzekutimin e vendimeve që u përkasin çështjeve të pronave dhe cenim të nenit 1 të protokollit 1, që është e drejta e pronës.

Qeveria shqiptare, pasi shqyrtoi me kujdes gjetjet e gjykatës në të gjitha vendimet e dhëna kundër saj, për sa i përket shkeljes së nenit 1 dhe protokollit 1 të konventës, si dhe rekomandimet në vendimin pilot “Manushaqe Puto kundër Shqipërisë”, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave të Këshillave të Europës mori një sërë hapash me qëllim ngritjen e një mekanizmi efektiv për dhënien fund të problemit sistematik të kthimit të pronave. Kryesorja është miratimi dhe zbatimi i ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Në vendimin e mbledhjes nr.1324, datë 20.09.2018, delegatët e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës u shprehën: “Komiteti e konsideroi ligjin nr. 133/2015 si një mekanizëm efektiv dhe zbatimin e tij të suksesshëm në praktikë”. Ai vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm mes autoriteteve shqiptare dhe Këshillit të Europës në procesin e hartimit dhe implementimit të mekanizmit të kompensimit.

Komiteti i vlerësoi rezultatet e rëndësishme të fituara në procesin e vlerësimit dhe kërkesave dhe numrin e vendimeve përfundimtare të nxjerra dhe zbatuara deri më tani, si dhe burimet shumë të rëndësishme të dhëna nga buxheti i shtetit për të mbuluar pagesën e të gjitha kërkesave për kompensim.

Komiteti vuri në dukje se zbatimi i ligjit nr.133 i dhjetorit 2015, duke përfshirë respektimin e afateve përkatëse, monitorohet nga mekanizma të rinj kombëtarë, të cilët kanë rezultuar efektiv.

Në përfundim, Komiteti i Ministrave në këtë mbledhje vendosi të mbyllë ekzaminimin e masave të përgjithshme dhe individuale, duke vendosur ndjekjen për 7 çështje, që kryesisht kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve të brendshme.

Gjatë vitit 2018 Komiteti i Ministrave vendosi mbylljen e monitorimit të çështjes “Mirgjoni kundër Shqipërisë”.

Ekzekutimet e vendimeve të GjEDNj-së gjatë periudhës janar – dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë ekzekutuar 4 vendime të GjEDNj-së të periudhës 2015- 2017. Vlera financiare e paguar për këto vendime është afërsisht 15 milionë lekë të vjetër.

Siç e përmenda edhe në fillim, me ndryshimet e fundit ligjore në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, pranë Avokaturës së Shtetit është ngritur Këshilli Konsultativ i Çështjeve në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, i cili, ndër të tjera, në kompetencat e tij ka: shqyrtimin e dokumenteve që disponojnë organet shtetërore në lidhje me çështjet e shqyrtuara nga GjEDNj, përcaktimin e një plani pune veprimi me afate konkrete për realizimin e detyrave në kuadër të ekzekutimit të një vendimi, paraqitjen e rekomandimeve dhe zgjidhjet e mundshme në kuadër të planit të punës apo planit të veprimit.

Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2019 Këshilli Konsultativ i Çështjeve të GjEDNj-së ka realizuar 6 takime, duke luajtur një rol aktiv në orientimin dhe marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit të GjEDNj-së.

Avokatura e Shtetit ka përfshirë vendimmarrjet e Këshillit Konsultativ dhe vlerësimet e tyre në planet e veprimit dërguar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës gjatë vitit 2019.

Krahas Këshillit Konsultativ, me qëllim zbatimin në kohë të vendimit të GjEDNj-së dhe marrjen e masave për ekzekutimin e masave të përgjithshme që ato përmbajnë, Avokatura e Shtetit ka bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Ministrave. Ne vlerësojmë se vetëm me një bashkëpunim ndërinstytucional dhe me përgjegjësi të të gjitha institucioneve kontribuuese për ekzekutimin e vendimeve të Gj.E.D.Nj-së mund të arrihet zbatimi i tyre i plotë dhe, më e rëndësishmja, respektimi i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Kjo ishte përmbledhja e raportit që unë kam dorëzuar, zoti kryetar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Metani, për paraqitjen e raportit!

Fjalën ia kaloj relatores, zonjës Bushka dhe pastaj kalojmë te pyetjet nga kolegët.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Metani, për ekspozenë e situatës në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Për opinionin publik, ashtu siç e tha edhe zoti Metani, është hera e parë që Avokatura e Shtetit raporton në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe ky raportim është i fokusuar vetëm në një çështje, pra se si shteti shqiptar i ekzekuton vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Për ta kuptuar, nuk është një raportim, siç jemi mësuar deri më sot, që bëhet nga institucionet që kontrollohen në kuadër të monitorimit parlamentar nga Kuvendi, por është raportimi i një institucioni, i cili për efekt të rëndësisë që ka në rivendosjen e të drejtave të shkelura të shtetasve, të cilat kanë gjetur përgjigje me vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, do të duhet të zbatohet nga institucionet shqiptare. Shtohet një mekanizëm kontrolli nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në mënyrë që të garantohet edhe më shumë rivendosja në vend e të drejtave që janë vlerësuar si të shkelura dhe që kanë nevojë për dëmshpërblim apo rehabilitim sipas vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Më duhet ta theksoj se në fund të vitit të kaluar 2018 ky komision miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për Avokaturën e Shtetit dhe në seancë plenare Kuvendi e miratoi ligjin, duke parashikuar edhe këtë mundësi të shtuar të kontrollit parlamentar për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si një garanci e shtuar për realizimin efektiv të të drejtave të shtetasve. Është një element i ri i shtuar kontrolli, i cili vjen edhe si një parashikim në dy rezoluta të rëndësishme të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, që u kërkon shteteve anëtare, përveç mekanizmave efektivë që kanë qeveritë ose institucionet e pushtetit ekzekutiv për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të përfshihen edhe parlamentet në kontrollin parlamentar

të këtyre çështjeve, që shtetasit të gëzojnë në mënyrë të plotë të drejtat që i njihen si të tilla nga vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Avokati i Shtetit na paraqiti një ekspozitë të të gjitha vendimeve të vitit 2018, por, në fakt, detyrimi i përkon një periudhë që kur ka hyrë ligji që ndryshonte ligjin e Avokaturës së Shtetit në vitin 2018, prandaj dua t'ju falënderoj që e bëtë dhe më të gjerë ekspozitën për të gjitha vendimet e 2018, madje e keni tejkaluar, pasi paraqitët edhe disa çështje të vitit 2019.

Nuk do të doja të përsërisja ato që u paraqitën deri në këtë moment nga Avokatura e Shtetit, thjesht do të doja të bëja disa pyetje, në fakt, edhe për opinionin publik, por edhe për kolegët e komisionit, që të kenë mundësinë të njihen me gjerësisht me gjithë këtë lloj aktiviteti .

Ju thatë që, sipas ndryshimeve ligjore të vitit 2018, për sa i takon çështjeve me vlera të vogla, tashmë keni një mekanizëm efektiv me të cilin nuk keni nevojë më që të kryeni shumë procedura, por menjëherë për çështje në vlerën deri në 10 mijë euro bëhet ekzekutimi i vendimeve. Keni parashikuar në ligj mekanizma efektivë që palët të mos sorollaten lart e poshtë me kërkesa por t'i përfitojnë menjëherë këto. Gjithashtu, keni bërë një ekspozitë të qartë të mënyrës se si janë ekzekutuar. Pyetja që kam është: A ka rezultuar vërtet efektiv mekanizmi që kemi parashikuar në ligj?

Pyetja tjetër është: Në nenin 19/7 të ligjit, sipas ndryshimeve që u bënë në vitin 2018, u parashikua e drejta e Avokaturës së Shtetit që të propozonte edhe ndryshime të nevojshme të legjislacionit ose praktikave administrative, të cilat mund të shkaktonin dëme financiare për shtetin si rezultat i shkeljes së Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Unë e di që ka kaluar një kohë shumë e shkurtër nga miratimi i ndryshimeve ligjore, por nga puna juaj, duke qenë se tashmë keni ngritur dhe këshillin konsultativ, pra keni bërë ristrukturimin e institucionit, keni punuar në drejtim të burimeve njerëzore, që mund të arrijnë të vlerësojnë situata që do të kenë nevojë për ndryshime ligjore, nga praktikat që keni pasur më parë nga vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, a keni konstatuar ndonjë rast të tillë, që ka nevojë për ndryshime ligjore?

Një nga arsyet se pse ju raportoni këtu është edhe që ne të shohim se çfarë duhet të përmirësojmë te "gabimet" që na janë kapur nga Gjykata e Strasburgut, që të kemi mundësinë t'i riparojmë, nëse është në dorën tonë, të bëjmë ndryshime ligjore përveç masave administrative që marrin organet e pushtetit ekzekutiv.

Vërej që pjesa më e madhe e vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, në vitin 2018 rastet kryesore të shkeljes i lidh me nenin 6 të konventës, që ka të bëjë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, dhe neni 3 që është ndalimi i torturës. Përveç



procedurave të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe akordimit të kompensimit financiar, a ka pasur propozime përkatëse nga Avokatura e Shtetit në drejtim të ndryshimeve në kuadrin ligjor apo të praktikës administrative për të parandaluar në të ardhmen këto kërkesa të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut për shkelje të këtyre neneve? Pra, në qoftë se pjesa më e madhe e vendimeve i referohet shkeljes së këtyre neneve, a ka nevojë të bëhet ndonjë ndryshim ligjor ose a ka nevojë të merren disa masa administrative në kuadrin e përgjithshëm që ne të mos përsërisim shkeljet dhe të mbahemi gjithmonë përgjegjës? Në këtë kuadër, a keni bërë ju propozime për këto dy çështje ?

Së fundi, ndryshimet në ligjin funksional të Avokaturës së Shtetit, në fakt, përcaktuan në mënyrë të qartë marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet e tjera, si: Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Agjencinë e Trajtimin të Pronës e të tjera, të cilat duhet të jenë tejet bashkëpunuese për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Si ka qenë ecuria e këtij bashkëveprimi institucional?

**Ulsi Manja**- Faleminderit zonja Bushka!

Zoti Metani, meqenëse janë disa pyetje që ka bërë relatorja, mund të vazhdoni t'i përgjigjeni këtyre pyetjeve, pastaj do t'i përgjigjeni pyetjeve të deputetëve.

**Artur Metani** – Atëherë, në lidhje me pyetjen e parë, nëse ka rezultuar efektiv mekanizmi për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve të GJDNJ-së me shuma nën 10 mijë euro, përgjigjja e menjëhershme është: po. Më lejoni ta shpjegoj! Deri tani e gjithë procedura e ekzekutimit të vendimit të Strasburgut nuk ka qenë e rregulluar nga asnjë akt ligjor, ka qenë e rregulluar nëpërmjet një praktike të vendosur prej vitesh në Shqipëri, çdo vendim kalonte për t'u miratuar në Këshillin e Ministrave, sipas procedurës që Këshilli i Ministrave ka për miratimin e vendimit të tij duke marrë mendime nga institucionet në afatet e veta. Në fakt, kjo procedurë zgjatej, e kur vinte puna për çështje me shuma të vogla 1 mijë euro, 2 mijë euro, e me radhë, pra nën 10 mijë euro ishte e pajustificuar mungesa ose një vonesë e tillë.

Mekanizmi që kemi vendosur në ligj, për mendimin tim, ka rezultuar efektiv, sepse ato raste që kemi pasur për t'u zgjidhur shpejt i kemi zgjidhur shpejt. Kanë qenë tri raste me shuma nën 10 mijë euro, të tria janë të ekzekutuara. Sigurisht që patëm pak vështirësi me Ministrinë e Financave sa gjetëm mekanizmin e komunikimit dhe mënyrën që do procedojmë, sepse ishte një mekanizëm i ri, Ministria e Financave kishte nevojë për kohën e vet, të balanconte praktikën e vet, por tashmë të tria vendimet janë ekzekutuar. Kështu që në këtë kuptim mekanizmi është super efektiv dhe mendoj që është një gjetje që është vlerësuar edhe

nga departamenti i ekzekutimit të vendimit të Strasburgut në bisedat që kemi bërë dhe nga shkëmbimi i informacioneve që kemi me njëri-tjetrin.

Në këtë kuadër do të vlerësoja jo vetëm këtë mekanizëm, por dhe atë që ju thatë, zonja Bushka, kontrollin parlamentar. Edhe pse ky institucion është në varësi të Kryeministrit unë e vlerësoj personalisht që është një mekanizëm shumë efektiv edhe për kontrollin e institucionit, por edhe për bashkëpunimin që ky institucion duhet të ketë me institucionet e tjera në kuadër të zbatimit të detyrimit të tij për ekzekutimin e vendimeve të Strasburgut, madje unë e shoh si një ndihmesë që i shërben më shumë Avokaturës se sa kontrollit parlamentar.

Në lidhje me pyetjen e dytë që është pak a shumë e njëjtë me të tretën, ne nuk e parashohim vendimin e Gjykatës së Strasburgut. Nëse gjykata ka ngritur pretendime për ndryshime ligjore sigurisht ne i vëmë në dijeni institucionet dhe mund të marrim masa për ta shpejtuar këtë proces. Nëse gjykata nuk ka ngritur një pretendim për ndryshim ligjor, siç ka pasur raste kur ka ngritur pretendime për ndryshime ligjore, ne mundohemi të bëjmë një analizë. Deri tani, këto 6 muajt e fundit nuk na ka rezultuar një nevojë për ndryshime ligjore, sepse janë çështje që vijnë më shumë për shkak të zbatimit të gabuar ose të vonuar të ligjit më shumë se sa vetë thelbit të ligjit ose dispozitës.

Për pyetjen e katërt: Si ka qenë bashkëpunimi, e vlerësojmë shumë të frytshëm bashkëpunimin me Këshillin e Ministrave me Ministrinë e Financave, veçanërisht me Ministrinë e Drejtësisë, me Gjykatën Kushtetuese dhe me prokurorinë për informacionet që marrim e shkëmbejmë me njëri-tjetrin dhe me Shkollën e Magjistraturës, sepse i gjithë institucioni ka hyrë në një seri trajnimesh me Shkollën e Magjistraturës sidomos për këtë pjesë, veçanërisht për pjesën e ekzekutimit të vendimeve.

**Andi Përmeti** – Si fillim, zoti Avokat i Shtetit, unë dua t’ju komplimentoj për punën që keni bërë, sepse para se të vija në këtë sallë kam qenë avokat dhe e njoh shumë mirë problematikën e Avokaturës së Shtetit. Më duhet ta pranoj se ne jemi mësuar që kjo pala këtej gjithmonë sheh vetëm zi për kë vjen andej, por nuk është e vërtetë, këtë radhë dua t’ju komplimentoj për punën që keni bërë në krye të Avokaturës së Shtetit.

Unë kam disa pyetje, së pari: Cilat janë problematikat që ka hasur institucioni juaj gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut dhe cilat janë masat e marra nga institucioni juaj?

Pyetja e dytë: A ka mundur institucioni juaj t’iu përgjigjet të gjitha rasteve të dërguara për ekzekutim?

Së treti, duke parë ankesat e dërguara nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, unë shoh që nga e gjithë shuma, diku te disa mijëra euro të vogla, janë për çështje të ndryshme

ndërsa një shumë prej 13 milionë 14 milionë euro janë për një çështje “ Sharrxhi kundër Shqipërisë”. Pyetja ime: Duke qenë se kjo paska marrë pjesën e madhe të luanit, a ka ndonjë proces ndërmjetësimi ndërmjet qeverisë shqiptare dhe zotit Sharrxhi për të ulur shumën e madhe të pagesës? A ka filluar pagesa? Ne nuk duhet të harrojmë se çdo ditë që nuk paguhet shtohen përqindjet mbi këtë shumë dhe këto përqindje për shkak të dashurisë së 17 majit i paguan populli dhe jo këta që i marrin lekët as ai që i jep lekët por populli.

**Ulsi Manja-** Vazhdojmë me përgjigjet.

Zoti Metani, ju lutem shkurt.

**Artur Metani** – Faleminderit, zoti Përmeti për konsideratën!

Sa i përket pyetjes së parë e gjithë problematika që ka pasur avokatura në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Strasburgut ka qenë pjesë e diskutimit në këtë sallë në dhjetor të vitit 2018 kur u bënë ndryshimet ligjore, me të cilat u munduam ta adresonim këtë çështje. Vlerësoj që për një mori të madhe çështjesh mekanizmi i gjetur ka rezultuar efektiv. Kështu që ne na duhet ta shohim këtë mekanizëm edhe më tej, pra të shohim nëse ka nevojë për ndryshime të tjera për këtë çështje.

Në lidhje me pyetjen e dytë, që të jemi të qartë, nëse pyesni ka çështje të paekzekutuara, unë po ju them se institucioni është përgjigjur ose është munduar t’u përgjigjet të gjitha çështjeve që ka ngritur gjykata. Ka çështje të paekzekutuara të cilat lidhen jo për shkak të një vullneti për ndryshim ligjor ose vullnet marrje masash të përgjithshme, por lidhet me shumën që gjykata ka vendosur, për shkak se buxheti i shtetit nuk është kaq fleksibël për ekzekutimin e vendimeve kaq të mëdha. Ky nuk është problem i institucionit, jemi munduar ta ngremë me Ministrinë e Financave, madje kemi ngritur edhe grupe të përbashkëta pune për mundësi negocimi dhe kjo lidhet me pyetjen e tretë që ju bëtë, sepse shuma është e madhe. Ajo nuk ndryshon, nuk ka mundësi negocimi, sepse është vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, por tentojmë të ngremë ura bashkëpunimi ose ura negocimi me palët për të parë skema pagese. Nuk kemi ende një rezultat.

**Vasilika Hysi-** Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Metani, për raportimin e parë që bëhet. Në fakt, është raportimi i parë që bëhet në Kuvend lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Unë kam në vijim të pyetjeve që bëri zonja Bushka konstatoj nga raporti juaj që ankesat që ka pranuar Gjykata Europiane të Drejtave të Njeriut në vitin 2018, 3 çështje kanë të bëjnë për gjykimin në mungesë dhe dy të tjerat kanë të bëjnë me hetimin efektiv. Ju në vitin 2019 keni marrë një vendim si këshill konsultativ për të adresuar çështje që nuk gjejnë rregullim në Kodin e Procedurës Penale. Konkretisht, Kodi i Procedurës Penale ka ndryshuar

në vitin 2017, në vlerësimin tuaj ndryshimet e bëra në vitin 2017 ende krijojnë vakum ligjor, pra nuk parashikojnë rregullime lidhur me gjykimin në mungesë? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me hetimin efektiv dhe zvarritjen. Ne kemi bërë disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Procedurës Civile, si dhe kemi parashikuar edhe kapitullin për dëmshpërblimin, por nga ana tjetër Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë kompetencë për të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që bëjnë zvarritje tej afateve të caktuara.

Unë këtu pajtohem me shqetësimin që ngriti me të drejtë kolegja Bushka, pasi sot ka ardhur koha që taksat dhe dëmshpërblimet nuk duhet t'i paguajnë më qytetarët shqiptarë, të cilët nuk kanë asnjë përgjegjësi, por duhet të zbatohet më mirë masat administrative dhe gjithçka që bëhet nga vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Dua të di se cila është marrëdhënia e institucionit tuaj me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, megjithëse kanë një periudhë shumë të shkurtër adresimi prej gati 6 muajsh? A i keni adresuar shqetësimet që keni adresuar lidhur me punën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve për hetimet e këtyre çështjeve?

Pyetja e tretë ka të bëjë me një çështje konkrete, “Pulfer kundër Shqipërisë”, bashkëshortja e të cilit shumë herë më kontakton edhe mua në cilësinë e kryetares së Nënkomisionit të të Drejtave të Njeriut. Më vjen çudi, megjithëse ka një vendim të Gjykatës së Strasburgut, prokuroria e rrethit Vlorë nuk jep raport për ecurinë e çështjes penale dhe ju përsëri e keni vënë në raportin tuaj.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është çështja “Pulfer kundër Shqipërisë”, ku zonja kërkon informacion sa i takon çështjes penale. Dua të di se cili është komunikimi midis jush, Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Çështjet Penale në rastet kur qytetari nuk merr informacion, që është minimumi?

Ju përmendët se keni marrëdhënie shumë të mira me Agjencinë e Pronave, me Ministrinë e Drejtësisë e kështu me radhë. Para 2 muajsh në Komisionin e Ligjeve raportoi drejtoresha e Agjencisë së Pronave dhe një sërë çështjes sikurse ju e dini, për shkak të tejkallimit të afatit prekluziv do të shqyrtohen në gjykatë. Për të shmangur zvarritjet dhe vonesat, pasi ju e dini që një pjesë e gjyqtarëve ende nuk janë vetuar, a keni menduar ndonjë adresim të problematikave nëpërmjet udhëzimeve me karakter të përgjithshëm që mund të japë Këshilli i Lartë Gjyqësor, për adresimin në kohë dhe me shpejtësi të mbi 8000 kërkesave, të cilat kanë dalë tashmë nga juridiksioni i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Metani.

**Artur Metani** – Faleminderit për pyetjet!

Më lejoni ta filloj nga pyetja e tretë. Ne jemi munduar ta adresojmë këtë çështje nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me Shkollën e Magjistraturës, së pari, për t'i orientuar të gjithë gjyqtarët e të gjitha gjykatave se cili është qëndrimi dhe qëllimi i ligjit, qëllimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës i shtatorit 2018 në mënyrë që vendimmarrja e gjykatave të jetë unison sa i përket qëllimit dhe zgjedhjes që ka vendosur ligji për këtë çështje. Me KLGJ dhe KLP-në nuk kemi vendosur një kontakt të drejtpërdrejtë për këtë çështje.

E para, sepse koha ka qenë shumë e shkurtër edhe për shkak të ngarkesës së madhe të punës që këto institucione kanë në këto momente të caktuara. Ne jemi munduar të adresojmë disa çështje, po ashtu edhe ato që ju ngritët në dy pyetjet e para nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, por këto janë komunikime të muajve janar-shkurt. Ne e kemi parë Ministrinë e Drejtësisë si interlektore në këtë proces, meqenëse ajo është ministria kryesore sa i përket hartimit dhe kodifikimit të akteve ligjore. Për shkak të emergjencave që institucioni ka në raport me Strasburgun ne e kemi parë më të udhës që të vendosim ura bashkëpunimi me organet e vetingut, si çështje prioritare për momentin, sepse janë çështje që do vijnë dhe ne kemi nevojë për një bashkëpunim më të madh dhe për këtë arsye kemi vendosur bashkëpunim dhe kemi hartuar marrëveshje të përbashkëta ndërmjet institucioneve.

Pra, sa i takon KLGJ-së dhe KLP-së janë çështje që do t'i ndjekim në vazhdim...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Eva Dyrmishi** – Sa i takon pyetjes së parë për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe gjykimin në mungesë, Gjykata e Strasburgut këto vendime i ka konsideruar efektive në lidhje me gjykimin në mungesë, por duhet të kini parasysh që këto janë çështje të vjetra të viteve 2010, 2011 dhe gjykata ka dalë me vendim në vitin 2018. Të gjitha këto ne ia kemi adresuar këshillit konsultativ, i cili nuk e ka parë si të arsyeshme që të merret ndonjë masë ligjore në lidhje me ekzekutimin e këtyre vendimeve dhe në këtë mënyrë po zbatohen vendimet e Gjykatës së Strasburgut, ku dy prej kërkuesve i janë drejtuar gjykatave të rrethit për të rifilluar rihapjen e çështjes, të cilat ne i kemi në ndjekje në vazhdimësi.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Zoti Alimadhi e ka kërkuar fjalën për pyetje.

**Adriatik Alimadhi** – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar avokat, unë kam një pyetje, në fakt, për gjetjet që kalon gjykata te paragrafi i tretë, në lidhje me zonjën Manushaqe Puto e të tjerë, në të cilën thuhet: “Ndryshimet e shpeshta të legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave”. A keni pasur ju ndonjë propozim

apo ide për ndryshimin e ligjit? Pra, përderisa këto vijnë për shkak të ndryshimeve të shpeshta në ligj kjo do të thotë që ka diçka që nuk shkon.

**Artur Metani** – Kjo gjetje që thoni ju është te ligji i vitit 2015....

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në vitin 2015 kur është miratuar ligji dhe nuk ka pasur më ndryshime ligjore, por vetëm dy vendime qeverie në zbatim të këtij ligji. Kjo gjetje ka të bëjë me periudhën para 2015-ës.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Metani!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam pyetje dhe komente. Mua më vjen mirë që Avokati i Shtetit varet nga Kryeministri, por siç e thatë edhe ju dhe relatorja vjen dhe raporton vetëm në komisionin tonë.

Zoti Avokat, para disa muajsh bëmë disa ndryshime esenciale në ligjin për Avokatin e Shtetit, pse jo edhe të trajtimit financiar të trupës suaj me idenë për të fituar sa më shumë çështje gjyqësore të shtetit. Dua të di, pavarësisht se ju jeni munduar t'i trajtoni sipas Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sa çështje janë trajtuar nga Avokati i Shtetit dhe sa çështje janë humbur? Nga kjo pikëpamje unë do të kuptoja vërtet, pavarësisht se ju keni bërë një raport për një vit e ca, se si është ecuria e institucionit tuaj në rastin konkret për trajtimin e çështjeve.

Pasi lexova materialin tuaj kam të drejtë të bëj një pyetje, e cila është më shumë teknike për ju sesa për mua, për opinionin tuaj si Avokat i Shtetit cila ka qenë cilësia e mbrojtjes dhe argumenti juridik sa i takon cilësisë së mbrojtjes të rastit “Sharxhi kundër Shqipërisë”, ndryshe nga paraardhësja juaj?

Pyetja e dytë, sipas vlerësimit tuaj, ajo ishte një çështje e humbur apo e shitur? Po ta shohësh të gjithë materialin shuma e miliona eurove për këtë çështje është, siç e tha edhe kolegu Përmeti, ndërsa të tjerat janë çështje qindarkash, e cila do të thotë se janë paratë që do të paguajnë taksapaguesit shqiptarë, pavarësisht se ju nuk keni mundësi, sepse duhet lidhur kontratë me Ministrinë e Financave të tjera me radhë. Unë mendoj se ne si komision duhet të dimë se sa cilësore është mbrojtja që bën Avokatia e Shtetit në rastet e veçanta, të cilat mbrojnë paratë e gjithë shqiptarëve.

Për këtë arsye e preka pak trajtimin financiar, nuk e kam personale, pasi në ligj ne kemi thënë që për raste të veçanta në qoftë se ne, ju në rastin konkret, nëse fitoni gjyqe të veçanta keni honorare të ndryshme që mund t'i merrni, duke u vlerësuar për punën e

jashtëzakonshme, të cilën shteti nuk jua paguan, kështu që nuk ka arsye pse ju të mos dëmshpërbleni. Në këtë kuptim dua të bëj lidhjen me atë që ne kemi bërë në ligj, të cilin e miratuam dhe e rregulluam ashtu siç e kërkuat ju, me aktivitetin të tanishëm të Avokatisë së Shtetit. Sa janë këto të përputhshme dhe a kanë ndikuar këto në rritjen e të ardhurave tona apo të fitimeve nga ne dhe nga Avokatura e Shtetit?

Me aq sa unë di, sidomos për rastin e fundit, për të cilin ju bëra dy pyetje, kam përshtypjen që është një çështje vërtet e humbur ose e shitur me vetëdije, nuk po them se kush e ka pasur si çështje, sepse nuk dua të bëj politikë, sepse edhe ty nuk të intereson, ndërsa mua po, ti je Avokat i Shtetit dhe je në atë detyrë për të sjellë fonde në buxhetin tonë, prandaj për rastin e fundit nuk ju pyeta kot, por ju pyeta politikisht.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Metani.

**Artur Metani** – Mua më duket i drejtë shqetësimi i zotit deputet, por nuk e di nëse është brenda objektit të raportimit...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Të lutem, për etikë dhe për kulturë, më quajnë Bashkim Fino! Jam deputet i Partisë Socialiste dhe kam 22 vjet në Kuvend. Shpresoj që të paktën ashtu siç dini emrin e disa deputetëve që kanë ardhur rishtazi dhe i vlerësove, të më vlerësosh edhe mua me këtë etiketim dhe jo me emrin deputet.

Nuk kam asnjë dëshirë të më kthesh përgjigje vetëm për atë që sapo thatë.

**Ulsi Manja** – Zoti Metani, ju lutem, vazhdoni me përgjigjet, pasi ato janë për opinionin publik dhe jo për njëri-tjetrin...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mos ma drejto gishtin mua se nuk jam shoku yt.

Ju lutem, vazhdoni zoti Metani!

**Artur Metani** – Çështja që u ngrit nuk është brenda objektit të raportimit që unë kam si detyrim, pra nuk ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit të Strasburgut, megjithatë, meqenëse e konsideroj si çështje të drejtë mund t'ju jap mendimin tim personal, i cili nuk ka lidhje me institucionin. Me aq sa unë kam informacion për çështjen Sharxhi, e cila ka qenë një çështje para se unë të shkoja në atë detyrë, edhe gjetjet dhe kontrolli i KLSH-së që kanë ardhur në institucion e kanë gjetur pa probleme. Kaq mund t'ju them për mbrojtjen që është bërë më parë.

Meqenëse u bë ndryshimi ligjor, duke rritur edhe pagesat ndaj avokatëve të shtetit, duke supozuar që në atë detyrë do të shkojnë profesionistët më të mirë, gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur vendimmarrje të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Këtë çështje do

ta shohim në vazhdimësi, sidomos për rastet e përfaqësimit të shtetit shqiptar në rastet e vetingut, të cilat janë paraqitur në Strasburg dhe aty do të shohim edhe cilësinë e mbrojtjes dhe bashkëpunimin që avokatët e shtetit kanë bërë gjatë kësaj periudhe.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka

Faleminderit, zoti Metani, për prezencën tuaj në komision!

Sot kishim një seancë raportimi të Avokaturës së Shtetit në Komisionin e Ligjeve në zbatim të nenit 19/9 të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar”, po nga Kuvendi. Natyrisht, relatorja dhe këshilltarët e komisionit do të përgatisin një raport të hollësishëm për këtë seancë raportimi dhe sipas Rregullores do t’ia paraqesim Kryetarit të Kuvendit, e cila do të botohen në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe më pas do të vazhdojmë me procedurat e njoftimit të deputetëve nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me Zëvendëskryemministren për politikën në shërbimin civil dhe zbatimin e tyre (raporti i Departamentit të Administratës Publike, për gjendjen në shërbimin civil, për vitin 2018)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Edmond Leka, Alban Zeneli, Andi Përmeti dhe Elda Hoti

#### **Mungojnë:**

Damian Gjijnuri dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Erion Braçe - Zëvendëskryeministër

Albana Koçiu – Drejtore në Departamentin e Administratës Publike

Agathi Kuramano – Drejtore në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit në Departamentin e Administratës Publike

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me çështjen tjetër që kemi në rendin e ditës, e cila është përsëri një seancë dëgjimore me zëvendëskryeministrin për politikën në shërbimin civil dhe zbatimin e tyre. Pra, është një raport i departamentit të administratës publike për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2018. Edhe për këtë seancë dëgjimore komisioni ynë është komisioni përgjegjës dhe relatori është kolegu Bashkim Fino. Nuk e di nëse ka ardhur zëvendëskryeministri, i cili e ka konfirmuar pjesëmarrjen. A ka ardhur zoti Braçe?

Ju lutem, ftojini të futet brenda!

Pra, siç e thashë edhe pak më sipër, do të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Është një seancë dëgjimore me zëvendëskryeministrin për politikën në shërbimin civil dhe zbatimin e tyre, pra është një raport i DAP-it për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2018.

Komisioni ynë është komisioni përgjegjës.

Në këtë seancë dëgjimore kemi prezent zëvendëskryeministrin, zotin Erion Braçe.

Zoti Braçe, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Bashkë me zëvendëskryeministrin është edhe zonja Albana Koçiu, drejtoreshë e DAP-it.

Komisioni i Ligjeve, si komisioni i përhershëm i Kuvendit, edhe në këtë seancë dëgjimore, është në ushtrimin e funksionit të kontrollit parlamentar. Me raportimin e zëvendëskryeministrit për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2018 ne e mbylлим raportimin e institucioneve që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve. Kjo është një çështje që meriton vëmendjen e duhur për t'u trajtuar nga Komisioni i Ligjeve dhe me një ndjeshmëri edhe për opinionin publik lidhur me gjendjen në shërbimin civil, por edhe me reformimin e tij.

Raporti përkatës i DAP-it është dorëzuar brenda afatit në Kuvendin e Shqipërisë në mënyrë të përmbledhur, por edhe me një relacion bashkëngjitur, i cili ndodhet mbi tavolinën e kolegëve deputetë.

Unë pa humbur kohë do t'ia kaloj fjalën zëvendëskryeministrit për të na bërë një prezantim të shkurtër të politikave në shërbimin civil dhe të gjendjes së shërbimit civil për vitin 2018.

Fjala për ju, zoti Braçe.

**Erion Braçe** – I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju faleminderit!

Siç e thatë, raporti i DAP-it është shpërndarë për të gjithë kolegët deputetë prej kohësh dhe sigurisht secili ka pasur mundësinë të njihet me të, si dhe me të gjitha zhvillimet në administratën civile përgjatë vitit 2018.

Ndërkohë unë do të doja të theksoja para këtij komisioni të nderuar se reforma në administratën publike ka vazhduar të jetë në qendër të vëmendjes të qeverisë shqiptare si pjesë e përpjekjeve të Shqipërisë drejt reformimit të shtetit edhe gjatë vitit 2018. Bazuar në masat e reformës në administratën publike të përcaktuara nën kontekstin e përgjithshëm strategjik, në strategjinë ndërsektoriale të reformës për administratën publike 2015-2020 dhe në planin kombëtar për zbatimin e MSA-së gjatë vitit 2018, qeveria shqiptare u fokusua në mënyrë të qartë në implementimin dhe garantimin e zbatimit rigoroz të legjisllacionit për nëpunësin civil në të gjitha institucionet e administratës shtetërore nëpërmjet koordinimit me të gjitha njësitë e burimeve njerëzore për njohjen, unifikimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha procedurave për përmirësimin e performancës së administratës publike dhe, së dyti, në reformën funksionale strukturore të institucioneve të administratës publike me fokus të veçantë në ristrukturimin e institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrave të linjës.

Gjatë vitit 2018, unë besoj se strategjia e reformës në administratën publike duhet shënuar si një prej arritjeve, që ka pasur një ecuri pozitive. Viti 2018 ka shënuar arritje për sa i përket realizimit të planit të aktiviteteve për secilën ministri në raport me detyrimet që kishte për administratën publike. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 u hartua plani i ri i aktiviteteve për periudhën 2018-2020, si dhe u vlerësuan nevojat financiare për zbatimin e strategjive për 3-vjeçarin e ardhshëm të miratuar në vijim nga Këshilli i Ministrave.

Numri i lartë i nënaktiviteteve në zbatim vetëm në vitin e parë të implementimit të këtij plani, 87% e totalit të tyre, në krahasim me vitin e parë të implementimit të planit të aktiviteteve për periudhën 2015-2017, që ishte diku te 63% e totalit, tregon punën intensive në rritje të institucioneve, në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara dhe në aftësimin më të mirë planifikues për hartimin e planeve dhe strategjisë.

Kuadri ligjor për nëpunësin civil paraqitet më i plotë dhe më i qartë si rezultat i ndryshimeve të miratuara në 5 akte nënligjore gjatë vitit 2018, akte të cilat rregullojnë fusha si pezullimi, lirimi, rekrutimi në nivel ekzekutiv të ulët e të mesëm të drejtuesve dhe vlerësimi i njohurive shtesë të tyre.

Një vëmendje e vazhdueshme i është kushtuar sigurimit të një trupe cilësore të nëpunësve nëpërmjet konsolidimit të një procesi rekrutimi të miratuar me ligjin nr. 152/2013,

të ndryshuar, ku fokusi kryesor është sigurimi i një procesi të drejtë konkurrimi për vendet vakante në shërbimin civil dhe bën më tepër transparencë në procesin e rekrutimit.

Kjo u bë e mundur përmes aplikimit të mekanizmave që garantojnë vlerësimin objektiv të kandidatëve, implementimit të masave për thjeshtimin e procesit dhe rritjen e transparencës nëpërmjet portaleve *online* të rekrutimit për aplikantët, publikimin e materialeve orientuese në faqen zyrtare të DAP-it, e cila përditësohet rregullisht me informacion koherent, organizmit të panairëve të punës dhe veçanërisht bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë.

Në këtë kuptim, gjatë vitit 2018 procesi i rekrutimit shënoi një rritje cilësore në drejtim të përqindjes së kandidatëve të kualifikuar, numrit mesatar të aplikantëve për pozicion pune, apo dhe përqindjes së plotësimit të nevojave për rekrutim. Konkretisht, përqindja e aplikantëve të kualifikuar, që është faza e paraseleksionimit për vitin 2018 ka qenë në nivelin 50,45%, duke shënuar një rritje në krahasim me vitin 2017, kur ky nivel ishte vetëm 14%. Numri mesatar i aplikantëve për pozicion vazhdon të jetë në trend rritës, ku, për vitin 2018, ka pasur një numër mesatar prej 22 aplikantësh për një pozicion pune, duke shënuar një rritje krahasimisht me vitin 2017, kur ky numër ishte vetëm 18.

Shkalla e zbatimit të planit të rekrutimit apo plotësimit të nevojave për rekrutim ka shënuar, gjithashtu, zhvillime pozitive, pasi për vitin 2018 realizimi i planit të rekrutimit ka qenë 100% në krahasim me vitin 2016, që ishte në masën 86%. Sa u takon lirimeve nga shërbimi civil gjatë vitit 2018, janë liruar 568 nëpunës, për arsytet e mëposhtme:

1. Pjesa më e madhe ka qenë për shkak të dorëheqjes (229 raste, ose 40% e tyre). Numri i lartë i dorëheqjeve shënohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me 29 raste, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural me 20 raste, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit me 15 raste, në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit me 13 raste;
2. Dalje në pension (112 raste, ose 19,7% e totalit);
3. Marrje e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” me 38 raste, ose 6% në total. Nga masat disiplinore “largim nga shërbimi civil”, të marra gjatë vitit 2018, më shumë se gjysma e tyre vijnë si rezultat i shkeljes disiplinore, mospërbushje e rëndë e detyrave, 20 rate të tilla, ose gati 52%, 9 prej te cilave kanë ardhur si rezultat i shkeljes disiplinore, moszbatim haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe 9 për shkak të shkeljes disiplinore, braktisja e punës, ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit. Numri më i lartë i masave disiplinore “largim nga shërbimi civil” shënohet në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit me 8 raste, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me 4 raste dhe në Agjencinë Kombëtare e Mjedisit po me 4 raste.

4. Për shkak të lirimit nga ligji nr. 138/2015, me 11 raste, (1,9%).
5. Për shkaqe të tjera, me 178 raste (31 %), të cilat përfshijnë:
  1. konstatim të pavlefshmërisë së aktit të emërimit, 7 raste;
  2. rasti i ndërrimit të jetës së nëpunësit civil, 4 raste;
  3. dënim me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, 3 raste,
  4. moskonfirmim në fund të periudhës së provës, 3 raste;
  5. caktim në organet drejtuese të partive politike, 2 raste;
  6. lirim pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme “jo kënaqshëm”, 1 rast;
  7. mosplotësimi i kushteve specifike pas emërimit, certifikatë sigurie nga DSIK-ja, 1 rast;
  8. arsye rekrutimi, 157 raste.

Sa i takon ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, strukturat përgjegjëse në DAP kanë evidentuar dhe analizuar problematika të hasura në komisionet e posaçme të ngritura pranë institucioneve shtetërore përgjegjëse për analizimin dhe rekomandimin për zbatim të vendimeve gjyqësore dhe kanë orientuar zgjidhje konkrete për mundësinë e sistemimit të gjyqfituesit në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të vendimeve të formës së prerë. Institucionet janë asistuar nga Departamenti i Administratës Publike për një kuptueshmëri më të qartë të urdhrit nr.5151/2015 dhe, si rrjedhim, zbatimit rigoroz të rregullave dhe modaliteteve që duhen ndjekur nga institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtyre vendimeve.

Si rezultat i punës së bërë, gjatë vitit 2018 janë zbatuar gjithsej 56 vendime gjyqësore të formës së prerë ose 22% më shumë se një vit më parë. Pavarësisht problematikave të hasura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duke marrë parasysh këtu edhe faktin që ka një numër të konsiderueshëm vendimesh gjyqësore të akumuluar ndër vite, nga viti 2014 e deri tani, në total janë zbatuar 189 vendime gjyqësore.

Mjafton të përmendim këtu vetëm disa nga rastet e zbatimit të vendimeve gjyqësore për punonjës të emëruar në detyrë gjatë qeverisjes deri në vitin 2013, të cilët janë liruar padrejtësisht nga shërbimi civil në periudhën 2010-2012 dhe tashmë janë rikthyer si pjesë e administratës, pikërisht për shkak të zbatimit të vendimeve gjyqësore. Për shembull, zonja Valbona Paluka, ish-drejtoresh e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, liruar nga shërbimi civil në vitin 2010, sot është drejtoresh e Përgjithshme pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për shkak të zbatimit të vendimit të formës së prerë të vitit 2018 të gjykatës; zoti Sokol Sheti, ish-drejtori juridik në

Ministrinë e Brendshme, liruar në 2012-n, është rikthyer si drejtor juridik në Ministrinë e Brendshme në vitin 2016 nga zbatimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë; zonja Sonila Shkjezi, ish-drejtoresh e Drejtorisë së Integritit, Kordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, kategoria e pagës II-b, është rikthyer në punë nga zbatimi i vendimit gjyqësor në vitin 2019.

Ndërkohë, vijon me prioritet zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Për sa u takon vendimeve akoma të pazbatuara, problematika kryesore e konstatuar është mungesa e administrimit në kohë reale e informacionit të nevojshëm për vendimet e marra nga gjykatat në çështje me palë ish-nëpunës civilë, për rastet kur Departamenti i Administratës Publike nuk ka qenë palë në proces.

Për zgjidhjen e kësaj problematike, gjatë vitit 2018 u dizajnuar platforma elektronike *administrata.al*, ku një ndër funksionet e kësaj platforme është edhe menaxhimi i informacionit për vendimet gjyqësore të formës së prerë. Nëpërmjet këtij mekanizmi, të gjitha institucionet e administratës shtetërore do të raportojnë në kohë reale për ecurinë e një procesi gjyqësor për nëpunësit civilë, duke përfshirë në raportim të gjitha detajet e nevojshme, jo vetëm për vendime gjyqësore të formës së prerë, por edhe për ato në proces. Kjo do të sigurojë një informacion të plotë për të gjitha institucionet e administratës shtetërore në lidhje me proceset gjyqësore dhe marrëdhëniet e punës në shërbimin civil.

Ky funksionalitet ka filluar të përdoret në prill të vitit 2019 dhe do të shoqërohet me trajnime intensive, me përfaqësues të drejtorive juridike dhe/ose burimeve njerëzore, në ministritë e linjës, në formën e grupeve të përbashkëta të punës, me qëllim grumbullimi në kohë reale të të dhënave.

Institucionet e administratës shtetërore janë të qarta tashmë për rolin që kanë në menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe për rolin e Departamentit të Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për menaxhimin dhe kordinimin e të gjitha procedurave që lidhen me burimet njerëzore. Gjithsesi, është akoma e nevojshme rritja e kapaciteteve të njësive të burimeve njerëzore në institucionet e administratës, për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil me fokus të veçantë në drejtim të planifikimit të vendeve vakante, si dhe grupimit të pozicioneve të ngjashme sipas tipologjisë së tyre.

Për sa i përket reformës funksional-strukturore, gjatë vitit 2018 vijoi puna për implementimin me sukses të formave të organizimit të brendshëm të aparatit të Kryeministrit dhe ministrive të linjës, të miratuara në fund të vitit 2017. Gjithashtu, u miratua tipologjia e institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrave të linjës.

U miratua modeli i ri i organizimit të institucioneve për sistemin e shëndetësisë dhe arsimit parauniversitar.

Riorganizimi funksional i institucioneve të varësisë u realizua duke mbajtur në konsideratë qëllimin kryesor të reformës së institucioneve të varësisë; garantimin e një administrate publike, mirëfunksionale, transparente dhe efeciente, që nxit zhvillimin ekonomik, konkurrueshmërinë e vendit dhe është e aftë t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve për ofrimin e shërbimeve publike dhe parimeve kryesoret të reformës; qeverisje me në qendër qytetarin; ulja e kostos së nevojshme për përgjigjet institucionale ndaj kërkesave të qytetarëve; nxitja e një administrate publike të orientuar drejt performancës, me fokus përdorimin efikas të burimeve publike dhe efektivitetit në arritjen e objektivave.

Rishikimi funksional-strukturor i institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrive të linjës do të vijojë edhe gjatë vitit 2019, duke u fokusuar në mënyrë shumë të qartë në identifikimin e rasteve ku ka nevojë të eliminohen mbivendosjet funksionale midis strukturave ekzistuese; identifikimin e rasteve ku ka nevojë të rishikohet funksioni, roli dhe organizimi strukturor i institucioneve; shqyrtimin e rasteve ku shihet i nevojshëm bashkimi i dy ose më shumë institucioneve apo krijimi i institucioneve të reja; shqyrtimin e rasteve kur është e nevojshme që institucionet të ndryshojnë pozicionimin e tyre; hartimin e modeleve të organizimit të sistemeve ministrore.

Zhvillime të rëndësishme janë shënuar në shtrirjen e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), duke e populluar sistemin me të dhëna dhe duke trajnuar personelin përgjegjës në secilin institucion për përdorimin e tij.

Në fund të vitit 2018, në sistem kishte informacion për mbi 50 mijë të punësuar, me një rritje prej 16 mijë të punësuarish ose 47% më shumë se një vit më parë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 janë trajnuar mbi 230 punonjës të sektorëve të burimeve njerëzore dhe financave, duke zhvilluar mbi 30 seanca trajnimi, të fokusuara jo vetëm për strukturat, organikat dhe hedhjen e të dhënave në dosjet individuale të të punësuarve.

Sot që flasim HRMIS-i përmban të dhëna për 69 mijë e 486 pozicione pune dhe dosje personeli për 57 mijë e 94 punonjës.

Në lidhje me gjenerimin e pagave nëpërmjet sistemit të HRMIS-ë, në fund të vitit 2018 ishin 90 institucione që gjeneronin bordero, urdhra shpenzimi dhe transfertën bankare sipas formatit të unifikuar në sistem, gjë që po standardizon kalkulimin e pagave të të gjithë punonjësve të administratës publike.

Sot numri i këtyre institucioneve është 111, ndërkohë që gjenerimi i pagës për të gjitha institucionet e shërbimit civil, përmes Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, mbetet sfida më e madhe për vitin 2019 dhe, natyrisht, do të realizohet brenda këtij viti.

Për sa i takon sigurimit të një trupe nëpunësish civilë me performancë të lartë në të gjitha nivelet e administratës, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme për t'i trajnuar profesionalisht, gjatë vitit 2018, ASPA ka përballuar një volum të madh pune, si në proceset e organizimit të aktiviteteve trajnuese, ashtu edhe në drejtim të rritjes institucionale dhe profesionale të saj.

Arritje në këtë drejtim janë shënuar në zgjerimin dhe diversifikimin e trajnimeve të ofruara për nëpunës civilë për të gjitha institucionet e administratës publike, në nivel qendror dhe lokal, si një mjet për të detyruar dhe rritur performancën në punët publike dhe konsolidimin e mëtejshëm të reformave.

Në shifra konkrete, gjatë vitit 2018 janë zhvilluar gjithsej 274 kurse trajnimi, një numër 40% më i lartë se ai i kurseve të trajnimit të zhvilluara një vit më parë.

Gjithashtu, numri i nëpunësve të trajnuar nga ASPA ka pasur një trend rritës, ku gjatë vitit 2018 ka qenë 5554 nëpunës, krahasimisht më 4700 të tillë të trajnuar gjatë vitit 2017.

Për vitin 2019 taskforca për marrjen e masave për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të vitit 2019 (e pashë si detyrim për ta raportuar pranë këtij komisioni), ka kryer disa aktivitete.

Qëllimi kryesor i kësaj taskforce kishte të bënte me garantimin e paanshmërisë në procesin zgjedhor të kandidatëve në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe burimet e saj, qofshin këto njerëzore, financiare apo logjistike, nëpërmjet marrjes së masave dhe monitorimit të veprimtarisë së administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të vitit 2019, në zbatim të detyrimeve ligjore, që vijnë nga vendimi nr. 283, datë 10.05.2019 i Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare, logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të vitit 2019", si dhe vendimit nr.284, datë 10.05.2019, po të Këshillit të Ministrave, për të njëjtën çështje, referuar zgjedhjeve vendore të datës 30 qershor 2019.

Në mbledhjen e taskforcës është diskutuar për të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve të administratës shtetërore, të drejtën e pjesëmarrjes jashtë orarit zyrtar në veprimtari politike, por gjithmonë duke respektuar kufizimet e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, duke mos shprehur publikisht bindjet dhe preferencat e tyre politike apo duke ndërmarrë veprime që konsistojnë në bërjen e fushatës për një subjekt politik apo kandidat; qenien protagonist në aktivitete dhe veprimtari politike apo manifestime me pankarta e të tjerë.



Në çdo rast, gjatë orarit zyrtar të punës është e ndaluar, për çdo punonjës të administratës shtetërore, nëpunës civil, administrativ apo edhe me kontratë pune, pjesëmarrja në veprimtari politike, fushatë zgjedhore, për parti politike ose kandidatë.

Gjithashtu, u përcaktuan dhe u morën masa konkrete nga taskforca për institucionet e administratës. Për shembull, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, u morën masa për monitorimin e procedurave të prokurimit, kontratat koncensionare dhe përdorimin e burimeve financiare në zbatim të vendimit nr.284, datë 10.05.2019, të Këshillit të Ministrave.

Nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë u morën masa për monitorimin e veprimtarisë së nxënësve të arsimit parauniversitar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Nxënësit, edhe jashtë orarit të mësimin, e kishin të ndaluar (dhe kështu ndodhi) të ishin pjesë e veprimtarive në kuadër të fushatës zgjedhore.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u morën masa për monitorimin e mospërdorimit në veprimtari të fushatës zgjedhore të automjeteve dhe çdo aset tjetër në përdorim të titullarit apo institucionit të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, si dhe titullarët e institucioneve u detyruan të publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare të internetit, me qëllim që ky numër të shërbente për denoncimin e çdo rasti ku janë përfshirë apo është kërkuar të përfshihen punonjësit e administratës shtetërore në veprimtari politike, në mbështetje të një partie politike apo edhe ndonjë kandidati në zgjedhje.

Gjithashtu, u kërkua edhe ndërhyrja e Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, si dhe e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të administrimit të shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, për të nisur inspektime e menjëhershme në kohë reale dhe marrjen e masave për çdo nëpunës të administratës të konstatuar në shkelje të detyrimeve ligjore, në situata dhune, të krijuara veçanërisht pranë komisioneve zonale të administrimit zgjedhor. Përfshirja e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari të paligjshme si: cenimi i pronës publike, pengimi mbarëvajtjes së punës së institucioneve shtetërore apo institucioneve në organizimin e procesit zgjedhor nuk u tolerua. Prandaj janë marrë menjëherë masa për nisjen e procesit disiplinor deri në largimin nga administrata publike, i nëpunësve të dhunshëm, veçanërisht i atyre të ndaluar nga Policia e Shtetit sipas ligjit, në kushtet e flagrancës të përfshirë në akte të dhunshme. Aktualisht jemi në fazën e mbledhjes së të dhënave nga të gjitha ministratë e linjës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, DAP-i, Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioneri i

Shërbimit Civil, me qëllim hartimin dhe dërgimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, i cili pa diskutim do të përfshijë të gjithë periudhën zgjedhore edhe ditën e zgjedhjeve dhe sjelljen pas tyre. Materialet e përcjella do të shërbejnë si raporte mbështetëse për hartimin e raportit të monitorimit, të sjelljes së veprimtarisë së administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të vitit 2019, i cili ndër të tjera do të përfshijë edhe gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR-it pikërisht lidhur me këtë aspekt. Për këtë arsye, unë besoj se është e vlefshme për ta vënë në dijeni edhe këtë komision lidhur me punën e *task force-s*, veçanërisht gjatë muajit të fushatës elektorale, ditës së zgjedhjeve dhe aktiviteteve pas saj, duke e vënë theksin edhe në një fakt tjetër, që gjatë kësaj periudhe organet që janë marrë drejtpërdrejt me mbikëqyrjen e nëpunësve të shërbimit civil në zbatim të ligjit kanë dhënë leje për një sërë nëpunësish për të qenë pjesë e administratës zgjedhore. Pa më të voglin diskutim ne do të presim, mirëpresim edhe gjetjet e KQZ-së, por edhe të Kolegjit Zgjedhor, që në rastet kur këta nëpunës të administratës civile janë përfshirë në akte gjatë procesit të administrimit zgjedhor, të cilat kanë qenë të ndaluara nga ligji, pa më të voglin diskutim do të jetë detyrë e DAP-it, Komisionerit për Mbrojtjen e Shërbimit Civil dhe e institucioneve të tjera për t'i larguar nga shërbimi civil.

Përtej të gjitha këtyre që thashë pa më të voglin diskutim ne jemi të vetëdijshëm që administrata publike ka ende probleme shumë të mëdha, probleme që lidhen drejtpërdrejt me detyrën e tyre funksionale, por edhe probleme që lidhen edhe me disiplinën krejt formale të paraqitjes në punë dhe respektimit të orareve zyrtare, jo vetëm këtu në Tiranë, në zyrat qendrore të administratës, por edhe në nivele lokale. Mbetet një punë shumë e madhe për t'u bërë edhe më tutje. DAP-i po punon fort në bashkëpunim edhe me ekspertë të BE-së në ato aspekte që ju thashë, por mbi të gjitha një aspekt i rëndësishëm, të paktën në gjykimin tonë, është ai i realizimit të përshkrimit të punës për çdo nëpunës të administratës publike, me qëllim që gjithsecili prej tyre të ketë të qartë punën që bën, të ketë në dosjen e tij vjetore objektivin që duhet të realizojë në harkun e një viti. Në bazë të atij përshkrimi pune dhe mbi bazën e këtyre dokumenteve të bëhet në fund edhe vlerësimi i punës së gjithsecilit, një vlerësim real, që mbështetet në përshkrimin e punës dhe në objektivat e realizuar dhe jo siç ndodh rëndom në një vlerësim krejt formal, përgjithësisht në masë të konsiderueshme pozitiv për gjithsecilin, pavarësisht se ende një pjesë e mirë e tyre nuk dinë se çfarë pune konkrete kryejnë në atë institucion qoftë qendror, qoftë edhe të varësisë dhe akoma më tej në nivele vendore, ku ky proces lë shumë për të dëshiruar. Këtu jemi fokusuar, jemi përqendruar dhe natyrisht bashkë me zhvillimet e reja që ndodhën gjatë vitit 2019 veçanërisht nën dritën e “Paktit për universitetin” unë mendoj se do të vijojmë të ecim përpara në rritjen e kapaciteteve të

administratës publike, në rritjen e cilësisë së shërbimit të administratës publike duke u mbështetur fort në ato dy aspekte që ju thashë, edhe në aspektin e një procesi real, rekrutimi në administratën publike, por nga ana tjetër në aspektin e vlerësimit real të punës së gjithsecilit në bazë të përshkrimit të punës së tij dhe të objektivave të vendosura që në fillim të vitit për t'u përmbushur nga secili nëpunës i administratës publike.

Faleminderit për vëmendjen!

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka kolegu Fino si relator i çështjes.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti Zëvendëskryeministër për ekspozenë e gjatë që bëtë!

Kjo tregon një punë të kujdesshme dhe të qetë që është bërë nga ana juaj. Nuk dua të zgjatem, sepse kolegëve u kam shpërndarë një tabelë, e kam këtu me të gjitha objektivat e lëna nga rezoluta e vitit të kaluar. Në rezolutën që do të bëjmë për këtë vit, gjithmonë veprojmë duke punuar në mënyrë të tillë që në 10 pikat që kemi trajtuar, zoti Zëvendëskryeministër, më lejoni t'ju them se rreth 8 nga këto çështje janë realizuar 100%, 2 janë në proces. Konkretisht, që të mos i lexoj të gjitha, të mos u marr kohën kolegëve, sepse e kanë mbi tavolinë, bëhet fjalë që të përfundojë rishikimi funksional strukturor i institucioneve të varësisë së administratës shtetërore që është një çështje në proces.

Çështja tjetër është për projektin e gjenerimit të pagave nëpërmjet sistemit HRMIS për të gjitha institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil e të tjera. Këta 2 objektiva janë në proces dhe duhet që të përshpejtohen pak në raport me 10 çështjet që sipas objektivave që kemi lënë në rezolutën e vitit të kaluar janë të gjitha të realizuara. Dua të bëj një sugjerim, duke përfituar që e drejtoni ju shërbimin civil, në rastin konkret DAP-in, duke përfituar nga rasti jo pse jeni zëvendëskryeministër, por keni qenë edhe kryetar i Komisionit të Ekonomisë është një çështje që unë e kam trajtuar shumë herë, në njëfarë mënyre e ka trajtuar edhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Cili është problemi që dua t'ju drejtoj ju? Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë edhe me një projektrezolutë që do ta bëjmë për vitin tjetër, për DAP-in, por edhe me projektbuxhetin e vitit që vjen, bëhet fjalë për disproporcionin e theksuar të pagave të nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe atyre në institucionet e pavarura. Unë kam folur gjatë për këtë çështje dhe nuk dua të zgjatem, e kam trajtuar në diskutimet e mia dhe në buxhetin e vitit të kaluar, por është një çështje, e cila do një kujdes të veçantë nga ana e qeverisë, sidomos nga DAP-i për të mos pasur një disproporcion kaq të theksuar të pagave të nëpunësve civilë dhe të administratës tjetër. Kur e shikoni të nevojshme që të realizoni dhe të ndërhyni për të bërë një parashikim të saktë dhe

të drejtë të tabelës së pagave dhe të hierarkisë së pagave duke filluar nga Presidenti i Republikës dhe deri te niveli më i ulët?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Braçe mund të përgjigjeni në lidhje me pyetjen e kolegut Fino lidhur me reformën në sistemin e pagave. Pastaj vazhdojmë me pyetjet e kolegëve të tjerë.

**Erion Braçe** - I nderuar zoti kryetar!

I nderuar zoti Fino, Departamenti i Administratës Publike ka nisur një punë lidhur me këtë çështje, që është ngritur me shumë të drejtë nga ana juaj, jo vetëm një herë, në shumë raste edhe këtu në Komisionin e Ligjeve, edhe pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, por edhe në seancat plenare të Kuvendit, është një çështje e drejtë, ashtu siç ju e shquani me shumë korrektësi diferencat janë të mëdha, madje për të njëjtin pozicion pune diferencat shkojnë edhe me disa herë, që do të thotë se pabarazia në këtë rast është shumë e evidente, shumë e qartë. DAP-i po bën një analizë të hollësishme të të gjitha pagave edhe të administratës publike, edhe të administratës vendore, ku kemi probleme akoma dhe më të mëdha, ku ende paguhen njerëz me gjysmë page thjesht dhe vetëm për të bërë qoka politike, partiake në funksion të qëllimeve elektorale, aq sa kanë çuar në denatyrim të buxheteve, por edhe të institucioneve të tjera të pavarura, kryesisht të atyre që nuk i kanë pagat të përcaktuara me ligj, me qëllim që sa më shpejt të jetë e mundur të vijmë para jush, para qeverisë dhe para institucioneve të pavarura me një raport të qartë ku të vendosim raporte të drejta midis pagave të këtyre institucioneve dhe institucioneve të tjera të administratës publike dhe asaj vendore, me fokus të qartë shmangien e diferencave të thella dhe një vlerësim real të punës së gjithsecilit edhe nga pikëpamja monetare qofshin institucione të pavarura, qofshin në institucione ku përfshihet edhe shërbimi civil, por edhe në institucionet vendore. Jemi duke punuar për këtë gjë dhe brenda këtij viti ne do të kemi një ekspozë shumë të qartë jo vetëm të asaj që është sot faktike, por edhe të asaj që ne duam të bëjmë lidhur me këtë çështje.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zoti Hyseni. Pastaj do të flasë zoti Përmeti.

**Alket Hyseni** - Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zotin zëvendëskryeministër për ekspozenë e gjerë të punës së Departamentit të Administratës Publike!

Më lejoni të bëj një saktësim, sepse sot këtu raporton zëvendësministri për sa i përket shërbimit civil dhe jo për të gjithë administratën publike, ajo është kompetenca dhe detyra që ka ai ndaj parlamentit.

Zoti kryetar, kam dy sugjerime. Do të kisha dëshirë, pavarësisht se zoti Fino nuk la asnjë hapësirë apo mangësi në raportim, por duhet të ishte një anëtar nga Nënkomisioni për Administratën Publike si relator në këto raste.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk ke lënë gjë mangët, por po flas si procedurë. Ka sens që të jetë ai nënkomisioni relatues për çështjen konkrete.

Do të doja të ishte Komisioneri për Shërbimin Civil, i cili është zëri dhe veshi i parlamentit për shërbimin civil, kurse ai është organi ekzekutiv zbaton detyrat, pavarësisht se ka një bashkëpunim shumë të mirë mes DAP-it dhe Shërbimit Civil në dijeninë e nënkomisionit. Ajo që vërej edhe në cilësinë personale si deputet, por edhe si kryetar i nënkomisionit është fakti se ende kemi mangësi në çështjet e vlerësimit për performancën. Zoti zëvendëskryeministër e ngriti shqetësimin se ajo bëhet formalisht, nga pikëpamja formale bëhet në mënyrë të përkryer, nga pikëpamja e brendësie apo e përmbajtjes është ajo që tha zëvendëskryeministri, pasi e tregojnë statistikak. Vetëm një person është larguar për shkak të performancës së dobët. Ligji parashikon se nëse ka performancë të dobët apo vlerësim negativ për 2 vjet, personi del nga shërbimi civil. Fakti që vetëm një person ka dalë dhe mos gaboj është këtë vit, vitin e kaluar nuk ka pasur, pra është hera e parë, po vijmë me një trend rritës, por jemi shumë larg asaj që duhet të jemi. Si do të procedojmë me mekanizmin e vlerësimit konkretisht? Sepse ka ankesa nga institucionet, të cilat thonë: “Po, kemi marrë një orientim që të mos kemi vlerësime pozitive”. Edhe në këtë mënyrë nuk zgjidhet, sepse djegim nëpunësit vërtet të mirë. Ne e dimë që në administratë punojnë 5 persona dhe qëndrojnë 10. Këtë po e them pa ndonjë bazë reale si shifër, por figurativisht, nëse ne themi se nuk do të ketë vlerësimin 1, do të djegim edhe këta 5 persona që punojnë, pra nuk i motivojmë. Departamenti duhet të gjejë një mekanizëm, hapësirën, qoftë edhe me ndryshime në legjislacion që vlerësimi të jetë konkret, të jetë ai produkti bazë nga largimet e administratës, që kur të vini pas një viti, apo dy vjetësh statistikak të jenë komplet ndryshe. Të mos kemi nëpunës që ikin me komisione, por të kemi nëpunës që ikin si të paaftë, sepse të jemi realistë që reforma më e vështirë që kemi për të bërë është ajo në administratën publike. Nëse e kapërcyem reformën në sistemin e drejtësisë dhe jemi në përfundim, reforma më madhore është ajo në administratën publike, e cila është domosdoshmëri edhe për shkak të integritimit, por nuk bëhet kjo me nëpunës të paaftë, as me ASPA-n, që vetë KLSH-ja dhe Komisioneri për Shërbimin

Civil, jam i sigurt edhe DAP-i e konstatojnë problematikën që ka, që është një institucion ende i paorganizuar saktë, që nuk ka një kosto, një program trajnimi eficient, që nuk u paraprin sfidave por shkon pas sfidave. Ky ishte shqetësimi i parë.

Shqetësimin e dytë e ezauroi vetë zëvendëskryeministri, për sa u përket nëpunësve të shërbimit civil që marrin pjesë haptazi në veprimtari të paligjshme dhe ne nuk mund të pranojmë, që të dalë një kryetar bashkie, që fatkeqësisht janë të gjithë të opozitës, e për herë të parë shohim se nuk ka nëpunës të administratës shtetërore të përfshirë në veprimtari politike gjatë fushatës elektorale, të paktën referuar raportit që na është sjellë, gjë që është për t'u vlerësuar, por nuk mund të mbyllim sytë kur një kryetar bashkie i përgjigjet në mënyrë harbute Departamentit të Administratës Publike, duke i thënë se kam zbatuar urdhrin tim dhe nuk po shkel ligjin.

Ne nuk mund të presim nëse e ngre apo s'e ngre komisionin ai drejtues atje. Duhet të bëjmë ndryshime ligjore, që në raste të tilla të ndërhyjë vetë departamenti. Jo pse janë të opozitës, por edhe në qofshin të maxhorancës. Nesër mund të jenë të maxhorancës dhe mund të gjenden para faktit që administrata shkel ligjin masivisht.

Sa u takon rekrutimeve, pyetja është: do të kënaqemi me statistika, zonja drejtoreshë? Kemi akoma mangësi në rekrutime, sado që jemi përmirësuar. Po ju jap një shembull nga zona ime elektorale. Ka pesë vjet që administrata tatimore ka pesë vende bosh. Pesë vjet. Dhe ne e shtrydhim atë administratë, që të rrisë performancën, e me të drejtë, por a nuk jemi ne në gjendje të rekrutojmë pesë njerëz, të cilët janë të domosdoshëm? Ka plot njerëz të arsimuar. Risi ishte futja e programit të studentëve të ekselencës, që ndoshta nuk vlen dot edhe në zonat periferike, nuk është efiçente, por mund të gjejmë mekanizmat, t'i rekrutojmë, ta bëjmë më me akses edhe vetë administratën, ta bëjmë më kërkuese ndaj rekrutimeve, sepse shpesh ia ngecim DAP-it, i cili pastaj e përcjell te administrata.

Janë një sërë mangësish, që ka nxjerrë në pah qoftë Komisioneri për Shërbimin Civil, qoftë KLSH-ja. Nuk e di nëse janë marrë parasysh, sepse në raportin e paraqitur nuk janë parashikuar nga DAP-i, por a janë marrë parasysh vërejtjet dhe mangësitë e konstatuara nga këto audite të herëpashershme. Njëri është nga parlamenti, tjetri është nga një institucion kushtetues.

E përmenda çështjen e ASPA-s, zoti zëvendëskryeministër, dhe në të gjitha raportet del negativisht. Duhet parë nëse është e llogaritur a nëse është e parashikuar nga Këshilli i Ministrave ndonjë reformë në këtë institucion, që t'i përgjigjet sfidave.

Këto kisha, edhe në formë diskutimi, por edhe si shqetësime e si pyetje.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zoti Braçe, mund të përgjigjeni.

**Erion Braçe** – Shumë faleminderit, zoti Hyseni!

Unë do të doja të thosha fare pak gjëra lidhur me shqetësimin që ju ngrini. Keni plotësisht të drejtë në lidhje me çështjen e vlerësimit të performancës të nëpunësit të administratës publike. Unë kam lëvizur vetë. Tirana ka qenë e fundit, zyrat e administratës qendrore, le të themi, ato të ministrive, kanë qenë të fundit, sepse nuk e mendoja kurrë, e këtë jua them sinqerisht, situatën e disiplinës formale. Po e lëmë pastaj pjesën e përkushtimit në punë, përmbushjen e detyrave, realizimin e objektivave e të tjera me radhë. Tirana ka qenë e fundit. Po ju them se kam gjetur zyra arsimore të mbyllura. E jo në orën tetë të mëngjesit, por edhe në tetë e gjysmë, edhe në orën nëntë. Dhe jo e munguar drejtoresha e arsimit, por i munguar gjithë personeli i zyrës arsimore. Nuk ishte as në Sarandë, nuk ishte as në Tropojë, por në Durrës. Unë personalisht, kam ndenjur dhe pritur aty më shumë se treçerek ore.

Po flasim për pjesën formale. Pra, edhe një herë: jo mungesë e drejtuesit, por e të gjithë nëpunësve. Këtu në ministri vazhdojnë ende të jenë në fuqi kontrata të trashëguara të kafeneve brenda ministrisë. Punonjës, nëpunës, të cilët në orën tetë të mëngjesit nuk shkojnë në zyrë të hapin kompjuterët, por shkojnë në kafe. Nën kontratë, brenda ministrisë.

Po ju them se kjo është ana formale. Po prapë te ana formale, në zyrat e personelit, ka nëpunës pa dosje personeli. Natyrisht, kur nuk ke një dosje personeli, ku të jetë shkruar çdo gjë që ka lidhje me historikun tënd të punës në atë institucion, pa diskutim që vlerësimi do të jetë formal. Prandaj, në nëntëdhjetë për qind të rasteve vlerësimi është “shumë mirë” për secilin prej tyre.

Çfarë kemi bërë? Kemi shkuar drejt dosjeve në sistemin e HRMIS. Pra, jo vetëm popullimin e sistemit, por edhe dosjen e personelit të tyre. Ka akoma shumë punë për të bërë. Ka shkuar 66 mijë numri në sistem, në HRMIS. Patjetër që do të shkojmë deri në fund me dosjen e personelit të gjithsecilit. Nuk e diskutoj këtë pjesë, por ama është një situatë e trashëguar në kushte të tilla, së cilës nuk i është kushtuar vëmendje.

Falë Departamentit të Administratës Publike dhe insistimit të Kryeministrit, po bëhet jo vetëm popullimi i sistemit, por edhe me dosjet e personelit të secilit prej tyre. Natyrisht, me përshkrimin e punës dhe objektivin e matshëm për gjithsecilin nga nëpunësit. Ju keni të drejtë që thoni: si mund të marrin vlerësime pozitive këta?

Unë po marr dy institucione, të cilat janë dy institucione të të ardhurave publike, që janë palca e shtetit, le të themi. Tani, kur plani nuk realizohet, si marrin vlerësime pozitive nëpunësit e Drejtorisë së Tatimeve dhe të Drejtorisë së Doganave? Si i marrin vlerësimet pozitive në nëntëdhjetë për qind të tyre? Si mundet? Ne po marrim vendime për të larguar

drejtuesit në nivel të lartë, por nuk shkon, nuk zërthehet detyra, objektivi, plani deri te nëpunësi më i fundit i këtyre institucioneve, të cilat, më lejoni të them, gëlojnë nga korrupsioni. E prapë, pavarësisht këtij fakti, marrin vlerësime pozitive nga titullarët, duke filluar nga përgjegjësi i sektorit, duke vijuar me drejtorin e drejtorisë, e pastaj me radhë, deri te drejtori më i rëndësishëm, që sipas shkallës hierarkike bëjnë vlerësimet e tyre.

Prandaj po i mëshojmë shumë fort dosjes për secilin nëpunës, përshkrimin të punës, si dhe objektivit për secilin nëpunës, me qëllim që vlerësimi të mos jetë më *a priori*, por të jetë i përputhur dhe i mbështetur fuqimisht në performancën e gjithsecilit prej tyre. Mua nuk më ka interesuar, as Departamentit të Administratës Publike nuk i ka interesuar fare, por edhe me drejtuesit e këtyre institucioneve po i mëshojmë shumë fort pjesës se nuk na intereson përkatësia politike e këtyre nëpunësve. Na intereson thjesht e vetëm rezultati. Përndryshe, do të kishim bërë edhe ne atë që kanë bërë të tjerët para nesh, që të paktën për këta që janë me vendime gjyqi do t'i linim atje kohë pas kohe, dhe nuk do t'i zbatonim asnjëherë. Jo. Edhe këtyre po i kushtojmë vëmendje dhe po i zbatojmë ato vendime, por nga ana tjetër, për çdo nëpunës tjetër do të kërkojmë: së pari zbatimin e ligjit, së dyti përmbushjen e objektivit sipas përshkrimin të punës. Përndryshe, nuk kanë pse rrinë më në administratën publike. Nuk i ka marrë askush me zor në administratën publike, e aq më shumë nuk i mban askush me zor. I mban thjesht e vetëm puna e tyre. Në rast se bëjnë punën do të rrinë, në rast se s'bëjnë punën do të largohen, ashtu siç e parashikon edhe ligji.

Së dyti, për veprimtarinë e paligjshme keni shumë të drejtë. Edhe gjatë këtyre tridhjetë ditëve të fushatës elektorale nuk është se s'ka raste të përfshirjes apo të denoncimit të personave që janë me statusin e nëpunësit civil, të përfshirë drejtpërdrejt në fushatën elektorale. Ne kemi urdhëruar ngritjen e komisioneve disiplinore, të cilat po merren edhe me këto raste, po ajo që ishte fenomen masiv gjatë gjithë kësaj fushate elektorale ishte përdorimi i nëpunësve publikë jo vetëm për veprimtari politike, por edhe për veprimtari haptas në kundërshtim me ligjin, të dhunshme në shumicën dërmuese të rasteve, e natyrisht kriminale në raport me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Natyrisht, ne po bëjmë analizën për secilin prej tyre, emër për emër, duke filluar nga ata që ka ndaluar Policia e Shtetit, duke marrë me radhë çdo person tjetër të identifikuar apo të denoncuar pranë task forces, si i përfshirë në veprime të dhunshme dhe aktivitet kriminal. Pa më të voglin diskutim nuk do të tolerohet asnjë rast, pavarësisht se i cilit nivel është, i nivelit qendror apo i nivelit vendor. Kushdo që i ka urdhëruar, pa më të voglin diskutim u ka bërë dëm.



Nga ana tjetër, kush ka marrë urën e zjarrit për të shkuar e bërë dëm në pronë publike, në pasuri publike, e në fund fare edhe në materiale e dokumente zgjedhore e kështu me radhë, do të mbajë përgjegjësi deri në fund.

Ashtu siç ju thashë, të gjithë ata nëpunës civilë, që në respektim të Kodit Zgjedhor e të ligjit kanë marrë pjesë në procesin e administrimit zgjedhor, por nga KQZ-ja apo nga Kolegji Zgjedhor identifikohen si të përfshirë në veprimtari të paligjshme brenda komisioneve apo grupeve të numërimit, do të largohen nga shërbimi civil pa më të voglin diskutim.

Sa i takon pjesës së rekrutimeve, unë mendoj se në këtë aspekt drejtoresha e Administratës Publike mund t'ju thotë diçka më tepër se unë, por ajo që ne kemi kërkuar me insistim ka të bëjë me identifikimin e vendeve vakante në Administratën Publike, brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur, e natyrisht zhvillimin e konkurseve reale për çdo vend pune.

Në lidhje me shifrat mund t'ju raportojë drejtoresha e Administratës Publike, e cila është edhe më e apdejtuar në lidhje me këtë proces.

**Albana Koçiu** – Faleminderit!

Nëse do të shkonim në një informacion më të detajuar lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për shembull, për vitin 2018 na janë kërkuar 139 pozicione për t'i shpallur, duke mbajtur në konsideratë se pozicionet sillen tek ne së bashku me kriteret e posaçme për secilin prej tyre, edhe me aftësitë që duhet të kenë kandidatët që duhet të vinë pranë procedurës së konkurrimit. Nga 139 pozicionet që kemi shpallur, na janë plotësuar, pra kemi kandidatë fitues për 96 pozicione, ndërsa 34 prej këtyre pozicioneve kanë rezultuar pa fitues në fund të procedurës së konkurrimit.

Pra, në total, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kemi një plotësim me 69 % të pozicioneve vakante të kërkuara pranë nesh.

Sigurisht që mbetet ende sfidë sidomos plotësimi i pozicioneve në rajone apo në rrethe, ku edhe kandidatët që vijnë e aplikojë kanë një nivel që lë ende për të dëshiruar në lidhje me plotësimin e atyre vendeve.

Gjithmonë ka qenë ky diskutim mes nesh, për të plotësuar pozicionet vakante me kandidatë të mirë, pra që kanë potencialin e duhur për të qenë nëpunës publikë. Prandaj kjo vijon të mbetet sfida jonë, që shpeshherë kemi pozicione vakante, të cilat mbyllen pa fitues, por ky nuk është shkak që të tolerojmë të kemi një performancë apo një kandidat me performancë pak më të ulët thjesht për hir të zënies së vendit të punës.

Sigurisht, mbetemi ende në bashkëpunim me institucionet e administratës, sidomos ato të shtrira në territor, për kuptueshmëri më të mirë të procedurave të shërbimit civil. Mbetet

ende sfidë kuptueshmëria e mënyrës se si hartohet një përshkrim i mirë pune, ajo që sapo thatë edhe zoti zëvendëskryeministër. Ne kemi bërë punë, por duhet të bëjmë akoma më shumë punë për të qartësuar institucionet se si plotësohet dhe si bëhet një format i mirë i përshkrimit të punës, si lidhet më pas me objektivat, si vendosen indikatorët për vlerësimin më pas të performancës së punonjësve në këtë drejtim.

Nëse do të jepja një përgjigje edhe lidhur me rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit në institucionet e administratës shtetërore lidhur me masat që ka lënë ndaj institucioneve, pra nëse doni ta dini, në total janë 28 rekomandime, nga të cilat janë marrë dy largime nga shërbimi civil, pesë pezullime nga e drejta e ngritjes në detyrë; mbajtjen e pagës deri në një të tretën nuk kemi asnjë nga institucionet që ta ketë reflektuar, por ndërkohë është dhënë një vërejtje dhe kemi njëzet ndërprerje të ecurisë disiplinore në pesë institucione ku Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer veprimtari verifikuese.

**Erion Braçe** – A mund të bëj një ndërhyrje të vogël fare, për të ndarë me ju edhe një problematikë, sa i përket çështjes së rekrutimeve? Po, është e vërtetë se institucionet reagojnë me vonesë, me vështirësi, sa herë duhet të njoftojnë vendin vakant, me qëllim që të nisë procedura e prokurimit. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh sepse brenda institucioneve, edhe drejtuesi i institucionit e ka pasur dhe e ka – e ne duhet të mundohemi shumë ta luftojmë këtë pjesë – idenë e familjaritetit brenda institucionit, jo familjaritetit për të marrë e të sjellë një njeri të familjes së tij. Jo. Është fjala për idenë e “njeriut tim”, dua “njeriun tim” atje, brenda institucionit. Nuk do ta tolerojmë më këtë gjë.

Pikërisht për këtë arsye është rritur numri i pjesëmarrësve në një procedurë konkurrimi, aq sa ka vajtur deri në 22 për një vend. Unë po e shfrytëzoj edhe këtë seancë për t'i bërë thirrje çdo të riu a të reje, që kërkon të bëhet pjesë e administratës publike, që ta shfrytëzojë këtë mundësi; të mos kërkojë as Erionin, as Albanën, as kryetar atje, apo asnjë nga deputetët, në konkurs do të jetë ai përballë atij komisioni dhe asnjë nga ne të tjerët. Nuk e marr përsipër unë dhe nuk ka për ta marrë përsipër askush secilin prej tyre kur të përballlet me komisionin e vlerësimit të asaj procedure. Të shkojnë të hyjnë e të konkurrojnë me dijet e tyre dhe mundësitë e tyre aq sa kanë nxënë.

Fenomeni i dytë, që është akoma në zhvillim e sipër, të cilin ne po e hasim shpesh dhe po e luftojmë shumë fort lidhet me studentët ekselentë. Edhe pse merren ekselentë, studentë shumë të mirë e të tjera me radhë, kalon një farë periudhe dhe drejtuesi apo titullari fillon dhe i shikon me një sy tjetër, jo me syrin e personave që kanë qenë këtu, kanë përvojë e të tjera me radhë. Ky është rasti fatlum, që personi s'ka përvojën e duhur për ta bërë këtë detyrë dhe,

natyrisht, i duhet stazhi, sidomos në institucionet që kanë natyrë fiskale. Në rastin më të keq, kalojmë prapë te historia: “Ky nuk është imi, ma kanë sjellë” dhe ne po e luftojmë shumë fort.

Ka edhe një fenomen të tretë, që është tejet negativ, lidhet me këta që hyjnë për herë të parë në këto institucione e fillojnë dhe artikulojnë fjalinë e famshme: “A do të bëjmë ndonjë punë për vete?”, ndërkohë që aty janë për t’i shërbyer shtetit në funksion të qytetarëve. Kjo lloj psikologjie duhet luftuar me shumë forcë, sepse, po zuri rrënjë edhe te këta që hyjnë për herë të parë si nëpunës në administratën publike, është e kotë t’u bëjmë përkushtim pune, t’u vendosim objektiva apo t’u kërkojmë më shumë sesa kaq, që të përkushtohen për t’i shërbyer qytetarit deri në fund. Pra, më shumë sesa vonesa e institucioneve për të shpallur një vend vakant, vëmendja e posaçme që po përkushton DAP-in në këtë histori është të përzgjedhim njerëz që nuk cetojnë dhe, natyrisht, të monitorojmë shumë fort drejtuesit e institucioneve, me qëllim që rekrutimet të mos kthehen në formale për shkak të titullarit të institucionit dhe mënyrës sesi e ndan ai punën në atë institucion.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zoti Përmeti. Pastaj fjalën e ka zonja Hysi.

**Andi Përmeti** – Zoti Braçe, unë kam dy shqetësime. Shqetësimi i parë lidhet me këtë që kam në tavolinë, ku thuhet: “Nëpunësi gjyqfitues” pra, nëpunësit e larguar pa të drejtë nga puna janë rikthyer në shërbimin civil në masën 32%. Kjo është vetëm për shërbimin civil, sepse për të gjithë administratën publike unë jam i bindur se kjo përqindje është shumë më e vogël dhe pyetja ime është: pse nuk janë rikthyer të tjerët kur kanë një vendim të formës së prerë gjyqësore? Pse të tjerët duhet të marrin nga dy pagesa ose nga tri për të njëjtin pozicion pune në pritje të rikthimit në pozicionin e tyre që ua ka dhanë me të drejtë gjykata?

Shqetësimi i dytë. Unë dëgjova disa emra personash, të cilët, pasi kanë fituar gjyqin në formë të prerë, janë rikthyer përsëri në detyrë, që është një lajm shumë pozitiv, por dëgjova që rikthimi ishte vetëm për disa emra dhe disa persona që janë larguar pa të drejtë me vendim të gjykatës gjatë viteve 2009-2013, a ka ndonjë emër të rikthyer gjatë viteve 2013-2017 që është larguar pa të drejtë dhe ka fituar gjyqin?

Zoti Zëvendëskryeministër, si kryetar i task forcës, ju thatë që fëmijët nuk janë përdorur në fushatë dhe, realisht, në Korçë nuk e kam parë një gjë të tillë, por, për të qenë i sigurtë me ju, kam parë përdorimin e fëmijëve dhe kam vënë re se sa ka qëndruar për një muaj Erion Veliaj me fëmijë në fushatë nuk ka qëndruar as Majkëll Xhekson gjatë gjithë jetës së tij. A është marrë masë për këtë?

Faleminderit!

### **Erion Braçe** – Faleminderit, i nderuar deputet!

Po e nis përgjigjen time nga pyetja e fundit. Unë iu referova ligjit dhe ligji ndalon përdorimin e nxënësve, që mësojnë në arsimin parauniversitar në mënyrë të organizuar në fushatë elektorale. Kësaj pike iu referova dhe kjo nuk ka ndodhur as në mitingje, në dijeninë time, që të jenë marrë fëmijë nga shkolla gjatë orarit të mësimit dhe të jenë çuar në aktivitete elektorale dhe nuk ka ndodhur as jashtë orës së mësimit. Iu referova kësaj si një element që task forca e ka pasur në vëmendje dhe i ka kërkuar me ngulm Ministrisë së Arsimit që ta monitorojë këtë proces qytet më qytet, domethënë në çdo njësi administrative kudo që ka qenë. Raportet janë pikërisht këto që unë po ju them. Në rast se ka ndonjë rast, ku në mënyrë të organizuar fëmijët janë hequr nga shkolla apo ka ndonjë rast, ku në mënyrë të organizuar pas mbarimit të mësimit në oraret e pasdites apo të mbrëmjes fëmijët janë marrë nga mësuesit apo drejtuesit e shkollave dhe janë dërguar në mitingje, unë i ftoj të gjithë që ta denoncojnë, por deri tani pranë task forcës nuk ka pasur raste të tilla, pavarësisht se ne kemi vënë adresa, telefona, emaile e të tjerë me radhë për t'i denoncuar këto raste. Ajo që ju thoni është një çështje tjetër, që nuk më ka takuar mua në drejtim të task forcës, por ka raste kur prindërit vijnë me fëmijët në dorë në fushatë elektorale dhe thonë: “dua foto”, sepse më kanë ardhur edhe mua, është e vështirë t'u thuash jo, sepse fyhet ose ofendohet, por kultura jonë e sjelljes me fëmijët lë shumë për të dëshiruar në raport me standardin.

Lidhur me çështjen e fituesve në gjyq, unë mendoj se drejtoresha mund t'u japë një statistikë edhe më të përditësuar, sepse ka qenë një çështje që ne e kemi ndjekur me shumë seriozitet gjatë gjithë kësaj periudhe, veçanërisht në muajt e fundit, me qëllim që t'i japim një zgjidhje përfundimtare, edhe për shkak të trysnisë dhe llogarisë që ka kërkuar kryetari i komisionit bashkë me relatorin, që ka qenë i njëjti edhe vitin që shkoi, për shkak se kjo çështje ka qenë edhe në rezolutën e Kuvendit.

**Ulsi Manja**- Po, zonja Koçiu.

**Albana Koçiu**- Për të qartësuar lidhur me këtë pikë, raporti që ne kemi paraqitur pranë jush i referohet viti 2018, i cili referon 56 vendime gjyqësore të zbatuara gjatë vitit 2018 ose 22% më shumë se viti 2017. Pra, shifra është krahasimore, jo se ne kemi zbatuar vetëm 22%. Nëse do të shkoja në vlerë reale përgjatë çdo viti, duke nisur nga viti 2014-2018, kemi 189 vendime gjyqësore të zbatuara, pra gjyqfitues të rikthyer në punë, ndërkohë që *backlog*-u apo sasia e vendimeve që ne kemi administruar ka qenë 301 vendime. Sot që flasim kemi ende 112 vendime të pazbatuara, por kjo problematikë nuk është një problematikë e thjeshtë në zbatim të procedurës që duhet të ndiqet për të zbatuar një vendim gjyqësor. Kjo ndodh për shumë arsye, së pari, për faktin që shpesh gjyqfituesit refuzojnë të sistemohen në pozicione

ekuivalente, pra aty ku ne i propozojmë, referuar edhe dispozitivit të vendimit të gjykatës. Kjo ndodh pasi nuk bien dakord me vendet e propozuara, megjithëse kanë të njëjtat kriteret dhe të njëjtën kategori page. Kështu që në këtë kuptim ne kemi diskutime dhe ecejake me gjyqfituesit dhe, sigurisht, duhet të gjendet një mekanizëm apo një instrument ligjor, i cili i detyron ata të pranojnë rekomandimin e dhënë nga komisioni i posaçëm. Ndërkohë, nga ana tjetër, kemi pozicionet e punës, të cilat ndryshojnë përshkrimin e punës, që është ndryshe nga ai i kriterëve dhe pozicionit të punës që ka mbajtur më parë gjyqfituesi. Në këto raste ekzekutimi bëhet i vështirë dhe shqyrtimi i pozicioneve të ngjashme kërkon kohën e vet.

Një problem tjetër janë specifikat e kriterëve të arsimit të këtyre gjyqfituesve, që nuk mund të rikthehen përsëri në pozicionet e mëparshme, pasi nuk plotësojnë kriteret e këtyre vendeve pune. Kjo është arsyeja pse vijon një proces komunikimi me gjyqfituesin, me institucionin që ka detyrimin për ta zbatuar, por sigurisht edhe me DAP-in.

Lidhur me shqetësimin e mëparshëm që shprehët, nëse kemi zbatuar vetëm vendimet përpara vitit 2014, sigurisht që jo, sepse shembujt që u dhanë nga zëvendëskryeministri ishin për të thënë që ne nuk shohim ngjyra politike majtas apo djathtas. Patjetër që vendimet gjyqësore të krijuara gjatë këtyre viteve janë objekt i shqyrtimit të punës sonë dhe kjo shifër, 189, nuk u referohet vetëm largimeve të bëra përpara vitit 2014, por edhe gjatë kësaj periudhe.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Koçi!

Zonja Hysi, fjala për ju.

**Vasilika Hysi**- Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit, zoti Braçe dhe zonja Koçi, për raportin dhe për prezantimin!

Unë dua të ndryshoj pak fokusin e pyetjeve, duke kaluar te detyrimi që ka institucioni juaj për të raportuar për zbatimin e rekomandimeve që institucionet e tjera kushtetuese ose të pavarura kanë lënë në lidhje me institucionin tuaj, me administratën publike dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në fakt, nga raporti juaj, por edhe nga raporti që ka përgatitur Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ka rezultuar një problematikë lidhur me përdorimin e sistemit. Cila është arsyeja që drejtuesit e institucioneve nuk e përdorin sistemin në kohë dhe nuk informojnë në kohë për të gjitha lëvizjet e stafit?

Së dyti, një nga shqetësimet që është konstatuar në raportin e KLSH-së janë problemet e financimit që vetë infrastruktura e DAP-it ka. Ju jeni një institucion shumë i rëndësishëm dhe pa mbështetjen tuaj të plotë financiare besoj se nuk mund t'i përmbushni dot detyrimet tuaja. Pyetja është për zëvendësministrin, meqenëse është njohës shumë i mirë i financave, a mundet që në kuadër të rishikimit të buxhetit për vitin 2019 të adresohet problemi për financimin dhe

garantimin e vazhdimësisë së punës lidhur me infrastrukturën e teknologjisë së informacionit në DAP?

Së treti, unë pajtohem absolutisht me atë që ju thatë për rekrutimet e reja. Nëse ju kujtohet para dy vjetësh në rezolutën që prodhoi Kuvendi i Shqipërisë kërkuam që DAP-i të bënte një punë informuese sensibilizuese nëpër universitete dhe me të gjithë ata që janë aplikantë të mundshëm, por me të gjitha përmirësimet e bëra, ende ka njerëz që janë mosbesues, a keni menduar të punoni ose të forconi bashkëpunimin me universitete për të parë një rishikim të kurrikulave të tyre, sepse ende sot ka profile pune në administratën publike që kërkojnë një përshkrim pune dhe terma reference kur shpallen vende specifike, ndërkohë që universitetet me përgatitjen e tyre nuk u përgjigjen nevojave të tregut të punës? Si mund të gjejmë një hapësirë për të arritur punësimin e studentëve në degë specifike, që kanë mastera specifike, të cilët nuk gjejnë vend në përshkrimet e punës që bën administrata në shpalljet e vendeve të reja të punës ose anasjelltas? Është e vërtetë që ju shpallni vende të reja pune, por nuk gjeni njerëzit e duhur, pasi përgatitjet ose programet e formimit në universitete nuk janë ato që duhen.

Shqetësimi i fundit që unë kam lidhet me studentët e ekselencës që kanë mbaruar studimet jashtë vendit. Ata kanë profile shumë specifike të shkollimit të tyre, për të cilat mund të kemi nevojën në Shqipëri, por që nuk e gjejnë vendin në raportimet e tyre dhe detyrohen të largohen përsëri, flas për degë të veçanta, që lidhen me fushën ekonomisë, ekometri, matematikës së aplikuar, inxhinierisë e kështu me radhë. A është menduar një mënyrë bashkëpunimi qoftë me administratën publike, por edhe me studentët e ekselencës, duke bërë vlerësimin e kërkesave të profileve të tyre, për të gjetur një hapësirë që të punojnë në Shqipëri dhe të mos ikin largohen përsëri vetëm se nuk kanë hapësira në këtë kuadër?

Këto ishin disa nga pyetjet që unë kisha, njëkohësisht kam edhe një rekomandim. Meqenëse në muajin dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të punës së institucioneve, dua të sugjeroj që në raportin që do të depozitoni në vitin 2019 të ketë një pikë të veçantë zbatimi i rekomandimeve të progresraportit të Bashkimit Europian për Shqipërinë lidhur me administratën publike dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve që kanë lënë për të gjitha institucioneve. Mos harroni që për vitin 2019 keni shumë rekomandime nga GREVIO, MONEYVAL-i, EKRI dhe nga një sërë institucionesh ndërkombëtare që kanë lënë detyra specifike për ASPA-n lidhur me kualifikimin e trajnimit të administratës dhe ndjekjen e impkatit ose trajnimeve të tyre në kategori të veçanta, siç janë gratë, fëmijët, e drejta e informimit, pjesë e konsultimit publik e me radhë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, zoti Zëvendëskryeministër!

Ju lutem, të fokusohemi te përgjigjet, sepse e shikoj që ka shumë kolegë, të cilët duan të bëjnë pyetje!

**Erion Braçe** - Mendoj se është çështje me interes.

**Ulsi Manja** – Kemi kohë gjithë ditën. Deri në orën 16:00, këtë punë kemi.

**Erion Braçe** – Kujtoja se do të mblidhnit komisionin tjetër, megjithatë, nuk ka problem, po përgjigjem edhe për këtë.

**Ulsi Manja** – Mund të vazhdoni!

**Erion Braçe** - Po e nis nga kjo e fundit.

E nderuar zonja Hysi, pa më të voglin diskutim që ne i kemi në vëmendje të gjitha raportet që adresoni për administratën publike, veçanërisht për Departamentin e Administratës Publike. Duhet të dini se ne jemi në një proces shumë të ngushtë me Komisionin Europian, pra me krahun ekzekutiv të Bashkimit Europian. Raportojmë dhe duhet të dini që raportimi atje është shumë konkret, nuk ka kthim pas, është marrë një angazhim dhe kërkohet thjesht dhe vetëm nëse është zbatuar, apo jo. Nuk na pranojmë as arsyetime dhe asgjë tjetër.

Në fillim të këtij viti kemi zhvilluar një proces shumë të mirë me Komisionin Europian në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Integritimit Europian, ku administrata është një nga elementet kyçe. Atje raportojmë në mënyrë të posaçme dhe pa diskutim përfshihen kërkesat apo rekomandimet, që kanë lënë edhe institucione të tjera, që ju i përmendët. Kështu që nuk e kemi fare problem që në raportin e vitit të ardhshëm të vendosim një pikë të posaçme se çfarë kemi bërë, edhe në përmbushje të rekomandimeve jo vetëm të raportit të progresit, por edhe të strategjisë së integritimit europian, pa më të voglin diskutim me fokus administratën publike dhe zhvillimet në të, si detyrime ndaj këtyre institucioneve.

Së dyti, ju folët për një proces informimi më të mirë dhe më intensiv pranë rrjetit universitar. Besoj se jeni në dijeni të faktit që ka ndryshuar komplet marrëdhënia jonë me universitetin në aspektin e administratës publike, por edhe në aspekte të tjera, të cilat kanë qenë thjesht dhe vetëm interesa të drejtpërdrejta të universitetit. Pra, “Pakti për universitetin”, që u prit me skepticizëm, u sulmua, u anatemua fort e të tjera me radhë, na i ka krijuar këtë mundësi. Informimi tashmë nuk bëhet thjesht dhe vetëm nga Departamenti i Administratës Publike, që ka qenë shumë aktiv për të informuar për vendet vakante në administratën publike të ofruara për studentët e ekselencës, por edhe me ndryshime të tjera, që ne i kemi bërë të gjithë procedurës, duke përfshirë brenda administratës publike studentë ende në procesin e formimit të tyre në universitet. Vetë Kryeministri ka ndërmarrë një tur universitet më universitet dhe ka

qenë prezent me drejtuesin e administratës publike, konkretisht me drejtoreshën, për t'i informuar për këtë gjë. Ministrinë dhe ministrat e linjës kanë një proces shumë të qartë në kuadër të “Paktit për universitetin”, të kontaktit dhe natyrisht të një informimi të vazhdueshëm të çdo fakulteti që përfshihet brenda fushës së veprimit të ministrisë, edhe për sa u përket çështjeve të administratës, por edhe për sa u përket marrjes apo dhënies së detyrave, të porosive, që deri dje bëheshin me tenderë publikë e të tjera me radhë, duke e përfshirë botën universitare brenda proceseve të qeverisjes, brenda proceseve që janë të dobishme për qeverisjen, si konsulencë, projekte, programe e të tjera me radhë, do të vijojmë ta bëjmë këtë gjë, sepse e kemi detyrim. Pak më vonë do të jem përsëri në një mbledhje të atij grupi që merret drejtpërdrejtë me zbatimin e “Paktit për universitetin” në ato drejtime kyçe, që janë përcaktuar bashkërisht me studentët e fakulteteve të ndryshme. Gjithashtu e shoh krejt racionale atë që ju propozuat për ata studentë që kanë kryer studime shumë specifike jashtë Shqipërisë dhe, natyrisht, duhet të na çojnë në një proces të rishikimit të kriterëve për proceset e konkurrimit për vendet vakante në administratën publike për t'i përfshirë, pse jo për t'i bërë akoma edhe më specifike kriteret, me qëllim që studentët, të cilët kanë zgjedhur të studiojnë jashtë në degë shumë specifike që lidhen në ato fusha që ju bëtë me dije, natyrisht të bëhen pjesë e administratës publike. Ne kemi shumë nevojë për njohuri të reja, për dije të reja dhe për përvoja të reja brenda administratës, veçanërisht në ato departamente pranë ministrive, që e kanë jetike përditësimin me njohuri të reja dhe, natyrisht, edhe me përvoja të reja, që mund të na vijnë nga këmbimi i dijeve dhe kulturave, që vetë studentët i kanë ndërmarrë në raport me formimin e tyre profesional brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braçe!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për financimin, zonja Koçiu.

**Erion Braçe** – Po, patjetër, unë e kuptoj që sa herë vjen korriku kërkesat për të ndryshuar buxhetin në drejtime të ndryshme janë shumë të mëdha; ma besoni këtë gjë. Ju jeni vetë deputetë dhe e dini fare mirë se sa nevoja ka në zonat tuaja elektorale dhe që fokus kryesor kanë qenë investimet publike, apo jo?! Ne e kemi adresuar problematikën që ka ngritur edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit bashkë me Departamentin e Administratës Publike, jemi në procesin e rishikimit jo vetëm të përgatitjes së buxhetit për vitin 2019, por edhe të buxhetit afatmesëm 3-vjeçar të shtetit dhe pikërisht kemi planifikuar rinovimin e serverëve të Departamentit të Administratës Publike dhe e kemi akomoduar në këto buxhete. Kështu që do t'i shkojmë deri në fund. Kur të vijmë me buxhetin e shtetit për vitin 2020, pa më të voglin diskutim që



administratën publike e kemi prioritet, jo vetëm për të rritur kapacitetet menaxhuese të vetë administratës publike, por edhe për t'iu përgjigjur deri në një detyrimeve që kemi kundrejt Bashkimit European për procesin e Planit kombëtar të Integritit të Shqipërisë në Bashkimit European.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braçe!

Zonja Bushka e ka kërkuar fjalën për pyetje.

**Klotilda Bushka** - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Braçe, për të gjitha sqarimet shteruese për pyetjet tona! Në fakt, më shumë e kam konstatim se pyetje; më pas kam edhe një pyetje.

E kam për drejtoreshën: në raportimin e vjetshëm kemi kërkuar, dhe kjo ka qenë pjesë e rezolutës, një analizë në lidhje me një vend pune, pra në ato raste kur kemi pasur shkarkime dhe kur me vendim gjyqësor të formës së prerë është vendosur rikthimi në detyrën e mëparshme. Ka ndodhur që një person të jetë riemëruar, një person të jetë duke pritur për t'u riemëruar dhe një tjetër të jetë në punë. Kemi thënë: ka raste kur për një vend pune paguajmë dy veta, ka raste që paguajmë tre veta. Kemi kërkuar një raport për këtë. Nuk e shikoj të pasqyruar, në qoftë se jam e gabuar dhe është... Në qoftë se nuk është, a mund të kemi një raport, për aq sa ju mundeni? Komisioneri për Shërbimin Civil ka sjellë të dhënat e tij për sa i takon administratës së njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nuk është i plotë, sepse të dhënat që themi ne, të cilat ju i dini bashkë me të gjitha problematikat, nuk mund të jenë kaq të sakta. Pra, nuk janë të prera me thikë, por ajo që unë shikoj në raport është një përmirësim i treguesve, pra nuk ka shumë shkarkime, referuar vitit 2015, ka rënë niveli i shkarkimeve; ka rënë niveli i numrit, kur për një vend pune paguajmë më shumë se dy veta dhe zbatimi i vendimeve të gjykatës është rritur jo shumë ndjeshëm. “Mbetet i ulët,- thotë raporti, - por ka ende punë për ekzekutimin e tyre”. Këtë pyetje e bëj, sepse, ashtu siç e kam thënë edhe vjet, janë para të buxhetit të shtetit, të cilat harxhohen për efekt të gabimeve të bëra nga administrata, kur shkarkohen padrejtësisht njerëz dhe në fund të kësaj analize duhet të jemi të aftë të gjithë, në të gjitha degët e administratës shtetërore, të bëjmë një analizë të përgjegjësive. Pra, nëse kemi disa vendime gjyqate për shkarkime, të cilat janë konsideruar të padrejta dhe na duhet sot të përballojmë nga buxheti i shtetit pagesa për vende pune, a dalin përgjegjësitë e atyre që e shkelën ligjin, kur shkarkuan njerëz, sepse për mua këto janë thelbësore në miradministrimin e administratës, të burimeve njerëzore? Nëse nuk është, mund ta sillni edhe më vonë, por është e rëndësishme që diçkaje të tillë patjetër t'i japim jetë dhe të kemi mundësi t'i bëjmë këto analiza. Për shembull, në qoftë se në një institucion kemi 20 vendime me rikthim në punë, dhe vazhdon i njëjti drejtor i burimeve njerëzore, atëherë kjo

nuk shkon ose njëjti titullar. Pra, duhet të bëhet patjetër kjo analizë, sepse janë përgjegjësi që ndikojnë direkt te financat e buxhetit të shtetit dhe të paratë e qytetarëve.

Së dyti, për efekt të vitit 2017, 4 muaj nuk kemi rekrutuar, për efekt të marrëveshjes që nuk duhet të punësonim, me qëllim që të mos quheshin rekrutime elektorale. Ka pasur një problem për sa u takon vendeve bosh, pra ka pasur shumë vende bosh, ndërkohë që ministrit, kur vijnë raportojnë në Kuvend thonë: “Jemi mangët me staf, nuk kemi cilësi, nuk kemi njerëz, sepse kemi pasur vakanca për efekt të mungesave që Departamenti i Administratës Publike ka krijuar, sepse ka pezulluar procedurat e rekrutimit”. Tani ky 4-mujor iku. Unë e kuptoj efektet e tij janë ndërë edhe në vitin 2018. A mund të kem sot një numër nga ju sa vakanca kemi në të gjithë administratën publike, që janë në pritje për t’u rekrutuar? A kanë ndikuar procedura si ato që konstatohen nga raporti i komisionerit për shërbimin publik? Për shembull, kur njësitë përgjegjëse të rekrutimit zgjasin në kohë procedurat e plotësimit të pozicioneve vakante, gjë që ndikon negativisht, thotë komisioneri, në efikasitetin e punës së punonjësve ekzistues për shkak të mbingarkesës së tyre dhe, nga ana tjetër, krijon mundësitë që titullari i institucionit me akte komandimi të nxjerrë pre tij, në mënyrë të kundërligjshme, të ngarkojë me detyra shtesë nëpunës civilë të institucionit dhe ka përmendur disa institucione. Pra, këto problematika, pavarësisht se janë krijuar nga një sërë shkaqesh, siç edhe ju i përmendni në raport, a janë tashmë në rrugë për t’u zgjidhur?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni!

**Erion Braçe** – Mendoj se drejtoresha ka informacione, në lidhje me atë që kërkoi zonja Bushka.

Dua t’ju them një gjë: pa diskutim që efekti i atyre 4 muajve ndihet, sepse është kohë e humbur dhe, natyrisht, duhet të plotësohet. Është njësoj si ajo historia e specialistëve të mjekësisë, që ka krijuar atë gëpin shumë të madh për mjekë në të gjithë territorin e vendit, sepse specialistët u lanë për vite të tëra pa mundësi për të ndjekur studimet në këtë aspekt. Në fakt, të them të drejtën, unë kam qenë kundër asaj marrëveshjeje (Ulsi e di), por që duhet nxituar në këtë aspekt, duhet nxituar dhe duhet ezauruar ajo që ju thoni, që zgjatet, zgjatet shpallja e një vendi vakant, pikërisht për të bërë atë që unë ju thashë: për të vënë njeriun tim atje, njeriun tim të besuar, jo njeriun tim që më bën punën, por njeriun tim të besuar atje. Pa diskutim që edhe kjo ekziston. Ne po mundohemi t’i monitorojmë në kohë, t’i shtyjmë fort të gjithë drejtuesit e institucioneve që kanë vakanca për t’i shpallur sa më parë dhe natyrisht, për të ndjekur më pas të gjithë procedurën pranë Departamentit të Administratës Publike, por duhet

të na kuptoni. Ne e kemi këtë mundësi në çdo aspekt, në aspektin ekzekutiv dhe në aspektin politik për t'i nxitur këta drejtues institucionesh në nivel qendror. Unë me përvojën e këtij muaji të drejtimit të task forcës të monitorimit të administratës, të burimeve njerëzore dhe të burimeve financiare të zgjedhjeve të 30 qershorit u them se është e pamundur për të diskutuar dhe për të pasur objektiva të përbashkët në këtë proces me pushtetin vendor. Është e pamundur të flitet me një kryetar bashkie që del në televizor dhe thotë: “Siç po i hiqni ju në Tiranë, do t'i heq edhe unë këtu”, dhe paguan 3 palë nëpunësish atje. Ky është një problem shumë i madh, pra çështja e borxheve të akumuluar në pushtetin vendor. Nuk janë thjesht borxhe, që vijnë nga punë të bëra dhe të papaguara, por janë edhe borxhe të këtij lloji, që e kanë çuar mbi 80 milionë euro borxhin që ka akumuluar pushteti vendor dhe që është dhe do të jetë një barrë e vazhdueshme për buxhetin e shtetit, gjë që na ka detyruar të vendosim rregulla të qarta se si do të përdoret qoftë transfertat e qeverisë qendrore, buxheti qendror përkundrejt vendorëve, qoftë edhe paratë që ata arkëtojnë nga taksat e tyre. Pra, është një sjellje e mbivendosur në kohë nga njëra qeveri në tjetrën, nga njëra administratë bashkiake në tjetrën dhe që, natyrisht, i jep efektet tani kur bëhet e madhe e të tjera me radhë.

Kështu që na besoni ne. Po mundohemi të ecim shumë fort në të gjitha aspektet, madje edhe në aspektin e zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatës për t'i rikthyer. Por edhe atje kemi një problem që, edhe kur ne duam ta zbatojmë vendimin e gjykatës brenda kontureve, që i tha pak më parë drejtoresha, marrim mbrapsht refuzime. E refuzon ai përsëri vendimin në fund, e refuzon përsëri vendin e punës që ne i ofrojmë dhe, në fund fare, në qoftë se ne marrim një vendim që nuk i pëlqen, shkon edhe në gjykatë, në të njëjtën gjykatë që i ka dhënë të drejtë, shpeshherë edhe në mënyrë të padrejtë. Por ne jemi të detyruar ta zbatojmë, shpeshherë edhe në mënyrë të padrejtë atje, ashtu siç gjendemi edhe përballë fenomenit, ku punonjësi mund të jetë larguar me plot të drejtë se ka shkelur ligjin e nëpunësit civil apo rregulla të tjera në administratën publike dhe është bërë bashkë me juristin e vetë institucionit, të cilët më pas kanë shkuar para një gjykate ku kanë rënë dakord me njëri-tjetrin, pra edhe juristi i institucionit, edhe nëpunësi i shkarkuar, edhe gjyqtari që të marrin vendim për ta rikthyer në punë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë nuk kam se si ta shpjegoj ndryshe që një nëpunësi, bie fjala të sistemit fiskal, të tatimeve, i cili kapet, zbulohet nga auditi i ministrisë, pastaj edhe nga Departamenti i Administratës Publike, në mashtrim të plotë të institucionit publik me diplomën e tij, gjykatësi i jep përsëri të drejtë. Ka mashtruar me diplomën! Këtë e kemi të verifikuar nga Ministria e Arsimit, nga ai palo universitet, ku ishte e të tjera me radhë, që ka mashtruar me dokumente,

por përsëri bashkë me juristin e institucionit shkojnë në gjykatë dhe bien dakord që ai të quhet i ligjshëm dhe të rikthehet në punë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po i ndjekim, po i ndjekim!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk është vetëm një rast!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Përmeti!

**Erion Braçe** – Jo, jo, nuk është kështu!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem! Rastet mund të jenë të ndryshme!

**Erion Braçe** – Në qoftë se unë kam mbaruar blegtori dhe kam deklaruar se kam mbaruar ekonomi, tani nuk ka... Unë besoj që vetëm ndonjëri mund të mos dojë ta kuptojë këtë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zonja Koçiu për përgjigjen e pyetjes tjetër.

**Albana Koçiu** – Për të raportuar pranë jush për një statistikë të saktë lidhur me sa gjyqe fituese ka për një vend pune dhe se sa rëndon në buxhetin e shtetit, në fakt, ky është edhe shqetësimi i DAP-it edhe gjatë gjithë kësaj periudhe. Mirëpo për shkak se marrëdhënia financiare është pranë institucionit që e ka krijuar këtë efekt, ndërkohë Departamenti ka marrëdhënien juridike të tij, pra të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve dhe detyrimin për ta zbatuar, kjo ka qenë një nga arsyet pse ne gjithmonë hezitojmë të raportojmë shifra kur vjen puna te vendimet gjyqësore, për shkak se edhe shumë shpesh vetë institucionet shkojnë si palë në gjykatë, pa e përfshirë Departamentin e Administratës Publike.

Në vijim të këtij shkëmbimi informacioni, ajo zgjidhje, që mendojmë se do t'i japë përfundimisht një vlerësim real kësaj situatë, është platforma “administrata.al”, të cilën e kemi lançuar, por e kemi edhe në raport.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Aktualisht, kjo platformë është funksionale për të gjitha institucionet e administratës publike, por do ta shtrijmë edhe në institucionet e pushtetit vendor, duke bërë të mundur që në këtë platformë të kemi 12 module *online* në kohë reale, në të cilat njësitë e burimeve njerëzore futen dhe hedhin të dhëna lidhur me të gjitha institutet e ligjit të shërbimit civil, përfshirë këtu

edhe një mekanizëm raportimi të veçantë për vendimet gjyqësore të formës së prerë. Kjo jo vetëm për vendimet, pra për ato që kanë marrë formë të prerë, por edhe për proceset...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, edhe një komunikim te platforma “Shërbej” dhe si një komunikim ndërmjet palëve për t’i ardhur më mirë në ndihmë trajtimit ashtu siç duhet të një procesi gjyqësor, i cili mund të jetë në një nga shkallët e gjyqësorit dhe ka nevojë patjetër për një mendim më të specializuar qoftë nga DAP-i, qoftë nga Ministria e Drejtësisë apo edhe nga institucionet palë në proces.

Mendojmë se kjo gjë do të sjellë edhe më shumë informacion real, do të bëjë të mundur shkëmbim më të saktë informacioni ndërmjet njëri-tjetrit, si dhe do të bëjmë të mundur t’ua japim këto informacione Kuvendit dhe të gjitha institucioneve të interesuara për të kuptuar se si është situata reale lidhur me vendimet, me impaktin në buxhet, lidhur me detyrimin që ka secili dhe, patjetër, edhe për të nxjerrë përgjegjësitë në fund të ditës, pra se kush janë ata të cilët, me veprimet e tyre me dashje ose pa dashje, pengojnë, por edhe që mund të ndikojnë në zbatimin e menjëhershëm të këtyre vendimeve.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Koçiu!

Nëse nuk ka pyetje të tjera nga kolegët, kam unë një pyetje, që, në fakt, e kam për studentët e ekselencës.

Në fund të vitit 2018, me vendim të Këshillit të Ministrave, janë rekrutuar në organet e qeverisjes qendrore studentë të ekselencës për një periudhë njëvjeçare në disa pozicione të shërbimit civil.

Komisioni European në takimin e Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike (G8) Bashkimi European – Shqipëri, i zhvilluar në muajin prill, e ka përshëndetur një iniciativë të tillë të qeverisë shqiptare, qëllimin e mirë të kësaj iniciative, por vë në dukje edhe pamundësinë që kanë këta studentë të ekselencës që, në përfundim të periudhës njëvjeçare të kontratës së punës që kanë në këto pozicione të shërbimit civil, të bëhen pjesë e shërbimit civil për shkak të kriterëve ligjore të pranimit në shërbimin civil.

Sot, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin “Për shërbimin civil”, për t’u bërë pjesë e garës në një pozicion të shërbimit civil do të duhet të kesh eksperiencë pune nga tre deri në pesë vjet, ndërkohë që kjo kategori e studentëve të ekselencës, të cilëve ua dhamë mundësinë për një vit, të jenë pjesë e shërbimit civil, pra përkohësisht, për një periudhë njëvjeçare, nuk e kanë mundësinë që nesër të konkurrojnë për të qenë pjesë e shërbimit civil për shkak të kësaj mungese eksperience, që në ligj thuhet: “tre deri në pesë vjet”.

A është menduar të kemi një amendim ligjor për këtë gjë?

**Erion Braçe** – Do të përgjigjet drejtoresha, sepse e kemi pasur shqetësim real këtë pjesë.

**Ulsi Manja** – Nëse është çështje ligjore...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Koçiu** – Jo, nuk është ligjore.

Të sqarojmë diçka, një nga arsyet e përfshirjes së studentëve ekselentë në administratën publike, siç e thatë edhe ju, ishte pikërisht mundësimi i një eksperience pune në administratë, me qëllim që nesër, kur të vijmë para procedurave që zhvillon Departamenti, të mos penalizohen për shkak se nuk kanë një eksperiencë në administratën publike.

Në fakt, po flasim këtu për nivelin ekzekutiv, pra nivelin “specialist”, për të cilin kërkojmë gjithnjë të paktën një vit eksperiencë pune në profesion.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht, nivelet ekzekutive kalojnë në një procedurë të tillë, pra duhet të kenë të paktën një vit eksperiencë pune, gjë që...

**Ulsi Manja** – Përputhet.

**Albana Koçiu** – ...e zgjidhim nëpërmjet këtyre *internship*-eve, duke u dhënë mundësinë studentëve ekselentë që të përfshihen.

Ndërkohë, për sa i përket faktit se ka pozicione pune të cilat kërkojnë dy vjet deri në tre vjet ose tre vjet deri në pesë vjet eksperiencë, ato janë pozicione pune specifike të parashikuara në legjislacione të veçanta. Për shembull, kemi audituesit e sektorit publik ose nëpunësit autorizues, që janë për shkak të ligjit “Për menaxhimin financiar” ose të ligjit “Për auditimin në sektorin publik”, që kërkojnë një profil të specializuar me eksperiencë për t’i ushtruar ato lloj detyrash ose funksionesh.

Në qoftë se do të shikonim shpalljen që ne bëmë për studentët ekselentë, do të vëmë re se i kemi përjashtuar këto kategori pozicionesh që iu ofruam ekselentëve. Edhe sot, po të shikojmë faqen *online* të Departamentit të Administratës Publike për shpalljet që bën, këto lloj pozicionesh pune, që kërkojnë ekspertizë të thelluar, ne i kemi përfshirë në procedurat tona normale të rekrutimit, jo në pozicione që u ofrohen ekselentëve. Kështu do të vijojmë të bëjmë edhe në vijim. Pra, do të ofrojmë pozicione pune për të cilat nuk kërkohet eksperiencë pune për studentët e ekselencës, ndërkohë që të gjithë këta të fundit, të cilët kanë një vend pune në administratën publike, në përfundim të afatit njëvjeçar do t’i nënshtrohen një procedure konkurrimi të parashikuar nga legjislacioni i shërbimit civil, duke pasur në konsideratë eksperiencën e tyre gjatë këtij viti, por edhe vlerësimet që u kanë bërë eprorët apo supervizorët e tyre gjatë këtij viti; edhe kjo është e rëndësishme.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

A ka diskutime?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Përmeti, e doni fjalën për diskutim?

**Andi Përmeti** – Po, për diskutim përfundimtar.

Zoti Zëvendëskryeministër, duke qenë se para se të vija në këtë sallë, e thashë edhe pak më parë, kam qenë avokat. Thjesht për ta ditur, në Gjykatën Administrative e kemi pasur gjithmonë tmerr, sepse është vërtet e vështirë të marrësh një vendim kundër shtetit. Kështu që unë jam i bindur që, pavarësisht ndonjë rasti konkret, për të cilin ju mund të keni të drejtë, pasi unë nuk e di konkretisht, është e vështirë të marrësh vendime kundër shtetit. Kështu që punonjësit e kanë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithsesi, është realisht problem...

*(Zoti Braçe ndërhyr pa mikrofon.)*

**Erion Braçe** – Më falni, se po ju ndërpres, kur shteti...

**Andi Përmeti** – Është njësoj sikur t'ju flas unë për ekonominë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ndizeni mikrofonin!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Andi Përmeti** – Ma mbyllët ju?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Jo, pa dashje!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Andi Përmeti** – Sepse i keni hequr në mënyrë... Më besoni! Ata që kam mbrojtur unë, janë hequr nga puna në një mënyrë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithsesi, ky është një tjetër diskutim, të cilit nuk dua t'i futem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zonja Xhina, zonja Hysi, ju lutem, të mos shfokusohehi nga debati!

**Andi Përmeti** – E drejtë!

**Ulsi Manja** – Jemi në fazën e diskutimit, ka një limit kohor, në mënyrë që të mbyllim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Andi Përmeti** – Ju lutem, të vazhdoj, se po më merrni kohën!

Unë do të doja t'u propozoja edhe kolegëve të mi, duke qenë se ky është realisht një problem për buxhetin e shtetit, madje ka qenë ndër vite, pavarësisht se cila qeveri është sot dhe cila vjen nesër dhe paguhet nga taksapaguesit shqiptarë, të kemi disa ndryshime rrënjësore në këtë ligj, në mënyrë që ne të arrijmë ta depolitizojmë, në kuptimin e plotë, administratën. Kjo do të thotë që nesër, kush largon nga puna pa të drejtë jo vetëm nëpunës civilë, por edhe në administratën publike (nesër do të kemi edhe reformën në drejtësi dhe ndoshta gjykatat do të jenë realisht më të mira se sa sot, dhe këtu duhet ta pranojmë), dhe ai person merr vendim gjykatë, përgjegjësinë monetare të asaj pagese ta mbajë titullari që e largon deri ditën që ai e kthen në punë.

Kjo administratë duhet të depolitizohet njëherë e mirë, dhe jo ju sot, por kushdo që do të vijë nesër qoftë nëpër bashki, qoftë në shtet, të mos i largojë njerëzit në mënyrë të frikshme me këto historitë e rikonstruktive të ministrive, të bashkive e të tjera, se të gjitha këto mënyrat procedurale ne juristët i dimë pak më mirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këtë do t'ua propozoja edhe kolegëve të mi të komisionit, pra që ne duhet të bëjmë disa ndryshime për të mbrojtur shtetin dhe këdo nëpunës, pavarësisht cila qeveri është sot dhe cila qeveri do të jetë nesër.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Përmeti!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse nuk ka diskutime të tjera...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Xhina! Zoti Përmeti!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë kam tri orë që ju dëgjoj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse nuk ka diskutime të tjera, shkojmë drejt përfundimit të kësaj seance dëgjimore, për të nxjerrë dy-tri konkluzione lidhur me raportimin e zëvendëskryeministrit dhe drejtoreshës së Departamentit të Administratës Publike. Sigurisht që është një seancë dëgjimore me interes për opinionin publik, sepse lidhet me një çështje shumë delikate, siç është shërbimi civil.

Proceduralisht, për të qenë korrekt dhe për t'i dhënë përgjigje edhe kolegut tim Alket Hyseni, zëvendëskryeministri dhe drejtoresha e Departamentit të Administratës Publike ishin këtu për të raportuar jo për çështjet e administratës publike në tërësi, por për të raportuar për



vitin 2018 në lidhje me zbatimin e ligjit “Për shërbimin civil”, pra vetëm për një pjesë të administratës publike, që lidhet tërësisht dhe që ka të bëjë me shërbimin civil.

Konstatohet nga raportimi i sotëm, siç e tha edhe relatori, kolegu Fino, se janë përmbushur plotësisht rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën e vitit 2018, madje puna e bërë nga Departamenti i Administratës Publike në lidhje me zbatimin e ligjit “Për shërbimin civil” është për t’u përshëndetur.

Natyrisht, problemet në shërbimin civil fillojnë që me ligjin, por edhe me zbatimin e ligjit “Për shërbimin civil” qoftë nga institucionet qendrore, qoftë nga organet e qeverisjes vendore.

Këtu ka raportuar Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Natyrisht që ka edhe një rezolutë të miratuar në Kuvendin e Shqipërisë për aktivitetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Problematikat që raporton Komisioneri dhe Departamenti i Administratës Publike janë pothuajse të njëjta. Nëse janë probleme të ligjit, zonja Koçiu, ju duhet të ndërmerrni masat dhe iniciativat e duhura ligjore që të ndërhyhet në ligjin për shërbimin civil me qëllim shmangien e atyre praktikave që kolegët i evidentuan me të drejtë këtu.

Ne nuk kemi buxhet dhe nuk e kemi portofolin plot që të paguajmë për një vend pune tre njerëz. Pavarësisht se ligji për shërbimin civil monitorohet rreptësisht nga Komisioni Europian, është përgjegjësi jona dhe s’kemi pse trembemi këtu, për të ndërhyrë në ligj dhe adresuar si duhet këto probleme. Gjithashtu, jam dakord që të zgjidhet po në ligj, siç propozon kolegu Përmeti, që ai drejtues i institucionit publik apo vendor që shkel ligjin për shërbimin civil duke larguar padrejtësisht njerëzit nga puna, të përgjigjet individualisht për dëmin që i shkaktohet buxhetit të shtetit. Vetëm kështu ne do të arrijmë të kemi një shërbim civil me punonjës të kualifikuar. Pra, çështjet që kanë të bëjnë me amendimet ligjore, nëse i keni konstatuar gjatë kësaj periudhe, duhet t’i adresoni një orë e më parë në Kuvend.

Për sa i përket shkeljes së ligjit për shërbimin civil nga vetë punonjësit e shërbimit civil gjatë periudhave zgjedhore, ky duhet të jetë fokusi i punës suaj të përditshme. Nuk duhen pritur as raportimet në Kuvend dhe as rezolutat e Kuvendit, por, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, por edhe me institucionet e tjera publike, që kanë detyra në kuadrin e zbatimit të Kodit Zgjedhor, duhet t’i identifikoni këta punonjës dhe në rast se shkelin ligjin ata nuk duhet të jenë më pjesë e shërbimit civil. Këta duhet ta ndajnë mendjen: ose në shërbimin civil, ose pas partive.

Në një nga rekomandimet që kemi lënë për Komisionerin e Shërbimit Civil, është edhe ndjekja me përparësi e këtij fenomeni, gjë e cila do t'i kërkoj relatorit të përfshihet edhe në projektrezolutën që do të miratojmë për Departamentin e Administratës Publike.

Sot kemi një raport paraprak nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Edhe pse nuk është pjesë e raportimit, sepse po raportohet për vitin 2018 dhe zgjedhjet vendore sapo i kaluam në 30 qershor, përsëri vihet re si fenomen. Madje këtë herë edhe me arrogancë më të madhe, sepse vetë drejtuesit e institucioneve, kryesisht vendore, marrin përsipër të bëhen mburojë e paligjshmërisë. Po këta punonjës që i kemi me demokraci pjesë e shërbimit civil dhe i kemi rekrutuar me procedura strikte për shkak të kualifikimit që kërkohet dhe kritereve të ligjit, nuk i kanë mend e kokës në rregull që dalin dhe hedhin molotov dhe benzinë ndaj institucioneve publike? Nuk e dinë që e kanë të ndaluar?

Prandaj, ne do ta fokusojmë në rezolutë, por mos prisni rekomandime të rezolutës së Kuvendit. Zbatoni ligjin, ndryshe nuk do të kemi shërbim civil.

Komisioni ynë ka vëmendjen e duhur në lidhje me Departamentin e Administratës Publike për sa i përket zbatimit të ligjit për shërbimin civil, por jo vetëm. Ne kemi Nënkomisionin e Posaçëm për Administratën Publike dhe në dijeninë time nënkomisioni ka zhvilluar një seancë dëgjimore për problemet e administratës publike për vitin 2018. Do të kisha pasur dëshirë që të tria nënkomisionet, i Administratës Publike, i Pushtetit Vendor, por edhe i të Drejtave të Njeriut, sa herë që zhvillojnë seanca dëgjimore në periudha të caktuara të punës së institucioneve që janë në sferën e përgjegjësisë së nënkomisioneve, të përpilojnë raporte periodike për Komisionin e Ligjeve, sepse është ky komision i përhershëm i Kuvendit që ka tagrin të marrë në analizë punën e secilit prej këtyre institucioneve në kuadrin e ushtrimit të kontrollit parlamentar, e pse të kërkoj shpjegime në nivele ministrore edhe në seancën plenare të Kuvendit.

Inkurajoj nënkomisionet që të kenë këtë praktikë komunikimi me Komisionin e Ligjeve për sa i përket mbikëqyrjes periodike të punës në Departamentin e Administratës Publike.

Do të duhet shumë shpejt që në një tjetër seancë dëgjimore në Komisionin e Ligjeve të kemi përsëri një raportim të drejtoreshës së Departamentit të Administratës Publike për sa i përket zbatimit të ligjit të dekriminalizimit, që është një nga fokuset e punës së këtij departamenti. Ky departament është përgjegjës edhe për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit të dekriminalizimit.

Departamenti ka sjellë një raport të posaçëm pranë Komisionit të Ligjeve, që do të duhet të merret shumë shpejt në analizë nga komisioni në një seancë dëgjimore të posaçme,

sepse mendoj që të dy këta komponentë, zbatimi strikt dhe me rigorozitet i ligjit për shërbimin civil dhe i ligjit për dekriminalizimin, do të na japin nesër një shërbim civil që do t'u shërbejë si duhet interesave të publikut.

Unë përshëndes punën e taskforcës së posaçme për administratën që kryesohet nga zëvendëskryeministri, zoti Braçe, por po ashtu edhe punën e Departamentit të Administratës Publike. Diçka ka filluar të lëvizë për mirë edhe për sa i përket zbatimit të disiplinës nga punonjësit e administratës publike, por mendoj që kjo duhet të jetë punë e përditshme dhe e përhershme e atyre që janë në krye të këtyre institucioneve. Nëse nuk e bëjnë si duhet punën këta që janë në krye të institucioneve, patjetër që fytyra e institucionit është fytyra e drejtuesit.

Nëse do të tolerojmë drejtuesit e këtyre institucioneve publike, qoftë në nivel qendror, qoftë në nivel vendor, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave të shërbimit civil, unë mendoj që përsëri do të kthehemi në pikën zero.

Prandaj, ngul këmbë që pjesë e rezolutës, që ne do ta diskutojmë në mbledhjen e ardhshme ... Ftoj relatorin zotin Fino, por edhe këshilltarët dhe Drejtorinë e Monitorimit të Kuvendit të përgatisin një projektrezolutë ku të përfshihen edhe sugjerimet dhe rekomandimet që dolën nga ky diskutim i sotëm dhe më pas t'ia përcjellim Kuvendit ditën kur do të raportojë zëvendëskryeministri.

Shumë faleminderit, zoti Zëvendëskryeministër, për prezencën sot në Komisionin e Ligjeve!

Shumë faleminderit, zonja Koçiu!

Faleminderit kolegë deputetë për këtë seancë të gjatë dëgjimore që patëm sot me dy institucione të rëndësishme, Avokaturën e Shtetit dhe Departamentin e Administratës Publike! Një falënderim e kam edhe për mediet që e kanë transmetuar sot nga fillimi në fund këtë seancë dëgjimore për shkak të rëndësisë që ka!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**